



ANALIZË

E TREGUT

TË TELEFONISË FIKSE

Tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse

Dokument për Këshillim Publik

(Miratuar me VKD nr.11 datë 27. 08 .2025)

INDEKSI I PËRMBAJTJES

I.	Përmbledhje ekzekutive	4
II.	Hyrje	9
	II.1 Analiza e tregjeve përkatëse sipas praktikës së Komisionit Evropian	11
	II.2. Procedura e Analizës së Tregut të zhvilluar nga AKEP	13
	II.3. Analizat e mëparshme në tregun e telefonisë fikse	15
	II.4 Praktika e BEREC dhe AKEP për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet fikse 17	
	II.4.1 Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe propozimi i KE 2016 për rishikimin e kuadrit rregullator.....	17
	II.4.2. Rishikimi i kuadrit rregullator të komunikimeve elektronike në BE	18
	II.4.3. Tarifat mesatare të terminimit fiks në vendet e BE/BEREC.....	18
	II.4.4. Praktika e rregullimit sipas benchmark të BEREC nga AKEP	21
III.	Tregu me pakicë i shërbimeve të telefonisë fikse	23
	III.1. Numri i pajtimtarëve e telefonisë fikse	24
	III.2 Trafiku telefonik i pajtimtarëve	28
	III.3 Tarifimi i shërbimeve me pakicë të rrjeteve fikse	30
	Paketat e integruara ne rrjetet fikse.....	31
	Akresi broadband nga rrjete fikse.....	33
	III.4. Përdorimi mesatar i thirrjeve telefonike fikse.....	33
	III.5. Portabiliteti i numrit Fiks	35
	III.7. Pjesët e Tregut dhe Tregues financiarë	36
	Pjesët e tregut.....	36
	III.8. Zhvillimet strukturore të tregut nga viti 2018 dhe në vijim.....	40
	III.9. Përfundim mbi ecurinë e tregut me pakicë të telefonisë fikse	42
IV.	Analiza e Tregjeve Përkatës me shumicë: Terminimi dhe Tranzitimi i thirrjeve ne rrjetet fikse.....	44
	IV.1. Përkufizimi i tregjeve përkatëse	44
	IV.2. Analiza për FNT e tregjeve te interkoneksionit.....	46
	IV.2.1. Terminimi i thirrjeve ne rrjetet fikse	46
	IV.2.2. Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse (FTR)	49
	IV.2.3. Tranzitimi i thirrjeve ne rrjetet fikse.....	51
	Tre kriteret e testit te aplikuar dhe ne nevojshme për ri-vlerësim ne mënyrë sintetike janë:	51
V.	Masat rregulluese për operatorët me FNT	56
	V.1. Masat rregullatore për tregjet me shumicë të interkoneksionit.....	57
	V.1.1. Masat rregullatore të propozuara për One Albania	57
	V.1.2. Masat rregullatore të propozuara për terminimin në rrjetet e Operatorëve Alternativë.....	58
	V.2.. Rregullimi i tarifave me shumicë të interkoneksionit.....	58
	V.2.1. Rregullimi i tarifave të FTR deri në vendimarrjen e vitit 2018	58

V.2.2. Skema e re reduktimit të FTR në Shqipëri.....	59
Aneks 1. Lista e sipërmarrësve të rrjeteve publike telefonike fikse të propozuar për status me FNT në terminimin e thirrjeve	60
Aneks 2. Lista e Pyetjeve për këshillim publik.....	61

Tabelat

<i>Tabela 1: Ndryshimet e listës së tregjeve nën rregullim në BE;</i>
<i>Tabela 2: Udhëzuesi i rishikuar i Komisionit Evropian Për Fuqinë e Ndjeshme në Treg;</i>
<i>Tabela 3: Tarifat tranzitore të terminimit për disa nga vendet e BE-së;</i>
<i>Tabela 4: Tarifat e terminimit fiks në vendet e rajonit (Eurocent/min);</i>
<i>Tabela 5: Tarifat mesatare të thjeshta të terminimit për vendet e BE, Shqipëri dhe rajon;</i>
<i>Tabela 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse sipas operatorëve (2018 - 2024);</i>
<i>Tabela 7: Numri i linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe operatorëve (2024);</i>
<i>Tabela 8: Volumi i minutave të origjinuara nga rrjetet e telefonisë fikse;</i>
<i>Tabela 9: Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (2019-2024);</i>
<i>Tabela 10: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit Broadband nga rrjete fikse 2019-2024;</i>
<i>Tabela 11: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike nga rrjet fiks i One Albania 2019-2024;</i>
<i>Tabela 12: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike celulare 2019-2024;</i>
<i>Tabela 13: Pjesët e tregut të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse (2019-2024);</i>
<i>Tabela 14: Ecuria e pjesëve të tregut të One Albania 2019-2024;</i>
<i>Tabela 15: Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve elektronike nga rrjetet fikse për operatorët kryesorë 2019-2024 (milion ALL);</i>
<i>Tabela 16: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fiks One Albania (2014-2024);</i>
<i>Tabela 17: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të OA dhe One Telecommunications (tashmë One Albania) për One Telecommunications fiks (2014-2024);</i>
<i>Tabela 18: Pjesët e tregut të One Albania dhe Info Telecom për tranzitim thirrjesh kombëtare të telefonisë fikse;</i>
<i>Tabela 19: Ecuria e tarifave të interkoneksionit 2014-2024 ;</i>
<i>Tabela 20: Propozimi për reduktimin e tarifave të interkoneksionit në rrjetet fikse.</i>

Figurat

<i>Figura 1: Tarifat FTR të terminimit në rrjetet fiks incumbent BEREC Qershor 2021 (eurocent/min);</i>
<i>Figura 2: Ecuria e tarifave FTR për Shqipërinë 2016-2024;</i>
<i>Figura 3: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të Telefonisë fikse 2018 – 2024;</i>
<i>Figura 4: Norma e penetrimit të telefonisë fikse sipas qarqeve (2024);</i>
<i>Figura 5: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse për 100 banorë 2015-2023;</i>
<i>Figura 6: Ecuria e thirrjeve nga rrjetet fikse dhe celulare 2018-2024;</i>
<i>Figura 7: Ecuria e volumit të thirrjeve dalëse nga rrjetet fikse;</i>
<i>Figura 8: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike dalëse Albtelecom fiks vs celular 2019-2024;</i>
<i>Figura 9: Ecuria e vëllimit të numrave të portuar 2018-2024;</i>
<i>Tabela 15: Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve elektronike nga rrjetet fikse për operatorët kryesorë 2019-2024 (milion ALL);</i>
<i>Figura 11: Pjesë e tregut për të ardhurat sipas operatorëve kryesorë fiks në 2024;</i>
<i>Figura 12: Ecuria e tarifave FTR për Shqipërinë 2016-2024;</i>
<i>Figura 13: Ilustrim i ecurisë së trafikut kombëtar fiks të tranzituar 2018-2024.</i>

I. Përmbledhje ekzekutive

1. Ligji nr. Nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, (në vijim Ligji 54/2024), në nenin 1 të tij, përcakton se qëllimi i ligjit është a) promovimi i zhvillimit të tregut të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, bazuar në shtrirjen dhe përdorimin e rrjeteve të shpejtësisë shumë të lartë, konkurrencën e qëndrueshme, ndërveprueshmërinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike, aksesueshmërinë e tyre, sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve, si dhe përfitimet e përdoruesit fundor; si edhe b) sigurimin e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun në Republikën e Shqipërisë, me cilësi dhe çmime të përballueshme, me mundësi zgjedhjeje për përdoruesit në konkurrencë efektive dhe që janë të afta të plotësojnë nevojat e përdoruesve fundorë, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, duke përcaktuar të drejtat e nevojshme të përdoruesve fundorë në rastet kur tregu nuk përmbush në mënyrë të kënaqshme kërkesat e aksesimit të shërbimeve në mënyrë të barabartë me të tjerët.
2. Terminimi i thirrjeve nga rrjetet fikse (FTR) është një shërbim me shumicë i ofruar nga operatori i një rrjeti fiks për t’i mundësuar konsumatorëve të rrjetit të tij marrjen e thirrjeve. Kur ofruesit e shërbimeve të thirrjeve nga rrjetet fikse ose mobile ju mundësojnë pajtimtarëve të tyre dërgimin (kryerjen) e thirrjes në numrat e rrjeteve fikse të Republikës së Shqipërisë, ata i paguajnë operatorit që u mundëson terminimin e thirrjes një tarifë me shumicë për këtë shërbim, që quhet ‘tarifa e terminimit të thirrjes në rrjetet fikse’. FTR-të përcaktohen mbi bazë tarifimi për minutë dhe aktualisht, sipas parashikimeve të legjislacionit të tregut të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, janë subjekt rregullimi, rregullim i cili bëhet nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).
3. Nëpërmjet këtij dokumenti për Këshillim Publik, AKEP synon marrjen e mendimit dhe komenteve të palëve të interesuara mbi propozimet për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve fikse me shumicë. Ky dokument përmban analizën e tregut të telefonisë fikse (tregjet përkatës me shumicë të terminimit dhe tranzitimit kombëtar të thirrjeve në rrjetet fikse) dhe është përgatitur në zbatim të ligjit nr.54/2024, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Dokumenti përmban një rishikim të përfundimeve të analizës së fundit të tregut të telefonisë fikse të kryer në vitin 2018 dhe masave rregulluese përkatëse për Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT). Dokumenti i analizës së tregut trajton zhvillimet historike, si dhe ndryshimet e ndodhura në treg dhe pritshmëritë e AKEP për të ardhmen e afërt dhe të mesme dhe masat rregulluese përkatëse për FNT në tregjet përkatës të analizuar.
4. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse është pjesë e rregullores për “Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.9, datë 17.7.2009, e ndryshuar (Rregullorja), sipas së cilës AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse si tregje të mundshme për ndërhyrje ex-ante në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike.
5. Qëllimi i analizës së tregut, shpalljes së operatorëve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse, marrja e masave rregullatore dhe miratimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë fikse është:

- a. Të promovojë efikasitetin e rrjeteve të telefonisë fikse;
 - b. Të promovojë konkurrencën e qëndrueshme në tregun me pakicë të shërbimeve të telefonisë fikse;
 - c. Të mundësojë përfitimet me të mëdha të mundshme të abonentëve nga shërbimet e komunikimeve elektronike;
6. Neni 44 “*Mekanizmi i konsultimit dhe transparencës*” si dhe neni 45 “*Konsultimi me palët e interesuara*” i ligjit 54/2024, parashikon detyrimin për zhvillimin e procedurës së këshillimit me palët e interesit për analizën e tregut duke përcaktuar edhe kohëzgjatjen minimale të periudhës së konsultimit publik e cila nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme.
7. Ky dokument i nxjerrë për këshillim publik përmban:
- identifikimin dhe përcaktimin e tregjeve përkatëse të analizuar;
 - analizë e konkurrencës në tregjet përkatës dhe vlerësimin nëse ka operatorë me fuqi të ndjeshme në treg (FNT);
 - masat rregulluese të propozuara për sipërmarrësit e vlerësuar me FNT, përfshirë rregullimin e tarifave për sipërmarrësit e përcaktuar me FNT.
8. Gjatë periudhës 2020 – 2024, në tregun vendas janë shënuar ndryshime të rëndësishme në tregjet e komunikimeve elektronike, si në aspektin e zhvillimeve teknologjike dhe cilësisë së shërbimit, ashtu edhe në aspektin e ndryshimeve strukturore të sipërmarrësve kryesorë që ofrojnë shërbime nëpërmjet rrjeteve fikse dhe atyre mobile. Disa nga zhvillimet kryesore strukturore paraqiten si më poshtë vijon:
- a. Përfitimi i kontrollit të shoqërisë ABCom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania sh.a., autorizuar me vendim e Komisionit të Konkurrencës nr. 676, datë 7.2.2020. Ndryshim i cili i ka mundësuar shoqërisë Vodafone Albania të jetë tashmë një ndër konkurrentët kryesorë edhe në tregun e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve fikse;
 - b. Sipas pikës 3 të VKD 23/2020, është vendosur kalimi i detyrimeve të vendosura për FNT (Fuqi të Ndjeshme në Treg), ndaj sipërmarrësit “Abcom” sh.p.k tek sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a, në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 24, datë 30.03.2018 “Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese” dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 77, datë 01.10.2018 “Për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”.
 - c. Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 855, datë 14.1.2022 ka vendosur për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nga përfitimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom sh.a., nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt);
 - d. Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimin nr. 869, datë 8.3.2022, autorizoi përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag;

- e. Këshilli Drejtues i AKEP, më anë të vendimit nr.14, datë 7.11.2022, ka miratuar transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të dhëna sipas regjimit të autorizimit individual dhe regjimit të autorizimit të përgjithshëm, si dhe për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP nga sipërmarrësi “Albtelecom sh.a.” te sipërmarrësi “One Telecommunications sh.a.”;
- f. Këshilli Drejtues i AKEP, më anë të vendimit nr.15, datë 16.12.2022, ka miratuar transferimin e të drejtave të përdorimit të disa frekuencave nga sipërmarrësit “Albtelecom sh.a.” dhe “One Telecommunications sh.a.” tek sipërmarrësi “Vodafone Albania sh.a.”.
9. Si rezultat edhe i ndryshimeve të ndodhura në tregun e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike (pika 8), duke filluar nga data 1 janar 2023 One Albania dhe Vodafone Albania ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të dyja tregjet e ofrimit të shërbimeve mobile dhe fikse. Të dy këto shoqëri janë sipërmarrësit me pjesët më mëdha në tregun e ofrimit të shërbimit broadband nëpërmjet rrjeteve fikse për numër pajtimtarësh.
10. Ky dokument që nxirret për këshillim publik përmban analizën e tregut për tregjet përkatës të mëposhtëm:
- 1) Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse;
 - 2) Tregu me shumicë i shërbimeve të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse.
11. Dokumenti përmban dhe një rishikim të ecursisë dhe zhvillimeve të tregut me pakicë të telefonisë fikse nga analiza pararendëse, efektet e rregullimit në tregjet fikse, si dhe paraqet propozimet e AKEP për statusin me FNT dhe masat përkatëse rregulluese për tregjet e analizuarat të vlerësuara për rregullim, si dhe propozimet përkatëse për de-rregullimin e tregut me shumicë i shërbimeve të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse.
12. AKEP ka konsideruar si një ndryshim të rëndësishëm strukturor zhvillimet që kanë ndodhur në tregun e telefonisë celulare dhe asaj fikse gjatë periudhës 2020-2024, si rezultat i të cilave tashmë One Albania dhe Vodafone Albania ushtrojnë aktivitetin e tyre si në tregun e telefonisë mobile, ashtu dhe në tregun e telefonisë fikse.
13. Për sa më sipër, AKEP në këtë dokument të nxjerrë për Këshillim Publik vlerëson se:
- Sipërmarrësi One Albania sh.a vlerësohet se përmbush kushtet për t’u shpallur me FNT në tregjet përkatës të mëposhtëm:
 - *Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të One Albania të ofruara nga vendndodhje fikse;*
 - Sipërmarrësi X i rrjetit alternativ X vlerësohet se përmbush kushtet për t’u shpallur me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin e tij, konkretisht në:
 - *Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të operatorit X të ofruar nga vendndodhje fikse.*
 - Në kushtet e propozimit për de-rregullim të tregut me shumicë të shërbimit tranzit të thirrjeve telefonike kombëtare në rrjetet telefonike publike të ofruara nga vendndodhje fikse, atëherë detyrimet aktuale të vendosura ndaj operatorit One Albania (ish-Albtelecom) nga analizat pararendëse, propozohet të hiqen. Afati për tërheqjen e

masave rregullatore ne fuqi, përcaktohet në vendimin e KD-së, sipas përcaktimeve të nenit 90 të ligjit 54/2024.

14. Bazuar në zhvillimet dhe kushtet e tregut të telefonisë fikse në Shqipëri, ashtu siç ka vepruar në proceset e analizave pararendëse, AKEP do të përdor tarifën benchmark të FTR të përdorura nga vendet BE/BEREC dhe ato të rajonit, pasi në kushtet e tregut në vendin tonë me një normë penetrimit të telefonisë fikse mjaft të ulët dhe me përdorimin gjithnjë e në rënie të shërbimit të telefonisë fikse, implementimi i modelit të kostos “Bottom-Up” LRIC i pastër siç rekomandohet në Rekomandimin e KE-së të datës 7 Maj 2009 do të përbënte një kosto që nuk do ta justifikonte përdorimin e metodologjisë LRIC për përcaktimin e tarifave FTR (Fixed Termination Rates).
15. AKEP në këtë dokument për këshillim publik propozon që tarifën e terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve të rrjeteve fikse One Albania, si dhe Operatorët Alternativë¹ të tjerë, të rishikohen sipas vlerave dhe afateve të përcaktuara në këtë dokument.

	Aktualisht	01.03.2026	01.09.2026	01.03.2027	Ndryshimi 2026/2025
One Albania (Lokal/Njëfish)	0.7	0.3	0.15	0.07	-57%
Operatorët Alternativë (Lokal/Njëfish)	0.7	0.3	0.15	0.07	-57%

Shënim: Tarifën në Lek pa TVSH

16. AKEP vlerëson që për sipërmarrësin One Albania sh.a i përcaktuar me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet telefonike publike fikse të ruajë detyrimet rregullatore të përcaktuara në nenet e ligjit 54/2024 si vijon:
1. Detyrimi i transparencës (Neni 93);
 2. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 95);
 3. Detyrimi për akses dhe përdorim të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve shoqërues (Neni 98);
 4. Tarifa e Terminimit (Neni 100).
17. Duke qenë se tregu me shumicë i tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse nuk është në listën e tregjeve të Rregullores nr.9 të AKEP, pas kryerjes së testit të tre kritereve, One Albania vlerësohet se nuk i përmbush kushtet për FNT tregun me shumicë të shërbimit të tranzitimit të thirrjeve telefonike nga rrjetet fikse kombëtare. Për këto arsye AKEP propozon heqjen e detyrimeve rregullatore aktuale për One Albania sh.a në këtë treg.
18. AKEP propozon që operatorët alternativë të rrjeteve të telefonisë fikse që plotësojnë kushtet për FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale të vijnë të kenë detyrimet e rregullatore të përcaktuara në nenet e ligjit 54/2024 si vijon:
1. Detyrimi i transparencës (Neni 93);
 2. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 95);

¹ <https://akep.al/publikime/regjistrat/>

3. *Detyrimi për akses dhe përdorim të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve shoqërues (Neni 98);*
4. *Tarifa e Terminimit (Neni 100).*

19. AKEP, si edhe në analizat pararendëse të tregut të telefonisë fikse, gjykon që operatorët alternativë të mos kenë detyrim për publikim ofertë referencë interkoneksioni, pasi kjo masë nuk është e nevojshme dhe do të ishte jo-proporcionale.

II. Hyrje

20. Ligji nr. Nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ne vijim Ligji 54/2024), në nenin 1 të tij, përcakton se qëllimi i ligjit është; a) promovimi i zhvillimit të tregut të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, bazuar në shtrirjen dhe përdorimin e rrjeteve të shpejtësisë shumë të lartë, konkurrencën e qëndrueshme, ndërveprueshmërinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike, aksesueshmërinë e tyre, sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve, si dhe përfitimet e përdoruesit fundor; si edhe b) sigurimin e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun në Republikën e Shqipërisë, me cilësi dhe çmime të përballueshme, me mundësi zgjedhjeje për përdoruesit në konkurrencë efektive dhe që janë të afta të plotësojnë nevojat e përdoruesve fundorë, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, duke përcaktuar të drejtat e nevojshme të përdoruesve fundorë në rastet kur tregu nuk përmbush në mënyrë të kënaqshme kërkesat e aksesimit të shërbimeve në mënyrë të barabartë me të tjerët.
21. Ligji 54/2024 ka zëvendësuar ligjin nr.9918, date 19.05.2008 ”Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim Ligji 9918) qëllimi i të cilit ka qenë që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.
22. Kreu XIII i ligjit, “Analiza e Tregut dhe Fuqia e Ndjeshme në Treg”, përcakton procedurën që ndiqet për identifikimin e tregjeve, që justifikojnë rregullimin dhe janë subjekt i rregullimit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, tregje që karakterizohen nga pengesa të larta dhe të qëndrueshme, me natyrë ligjore ose strukturore për hyrjen në treg, tregjet të cilat nuk janë të orientuara drejt konkurrencës efektive, brenda një periudhe kohore të përshtatshme, tregjet ku zbatimi i vetëm i ligjit të konkurrencës nuk mund të zgjidhë në mënyrën e duhur dështimet e tregut. Gjithashtu, ky kre përmban kriteret e përdorura nga AKEP për vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg, detyrimet/masat rregulluese në rast të gjetjes së sipërmarrësve me FNT.
23. Në përputhje me parashikimet e rregullores nr. 9/2009 “Mbi analizën e tregjeve”, e ndryshuar, si edhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Evropian, në këtë dokument jepet përkufizimi i detajuar i tregut përkatës, dimensionit gjeografik dhe ai i produktit/shërbimit.
24. Ky dokument i nxjerrë për këshillim publik përmban analizën e tregjeve me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse. Dokumenti përmban një rishikim të përfundimeve të analizës së tregut të telefonisë fikse të kryer në vitin 2018 dhe masave rregulluese përkatëse për operatorët e përcaktuar me FNT në tregjet përkatëse.
25. Rishikimi dhe rregullimi i tregjeve të komunikimeve Elektronike është një proces mjaft teknik dhe kompleks, dhe si i tillë bazohet në implementimin e plotë të legjisllacionit Shqiptar, gjithashtu merr në konsideratë edhe një sërë udhëzimesh dhe rekomandimesh të Komisionit Evropian për të vënë në zbatim praktikën sa më të mirë në fushën e rregullimit të

komunikimeve elektronike në vendet e Evropës dhe rajonit, me qëllim nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike.

26. AKEP, me vendimin nr.747, datë 17.7.2009, ka miratuar Rregulloren për Analizën e Tregjeve (në vijim referuara si Rregullorja), dhe me vendimin nr. 2342, datë 31.7.2013, ka miratuar amendime të kësaj Rregulloreje. Rregullorja përcakton midis të tjerave një listë prej 7 tregjesh për t'u analizuar nga AKEP për FNT, si dhe detyrimin për të kryer testin e tre kritereve për tregjet që nuk janë pjesë e listës së tregjeve të Rregullores ose e Rekomandimit në fuqi të Komisionit Evropian për tregjet përkatëse të dyshuara për ndërhyrje 'ex-ante' në sektorin e komunikimeve elektronike. Lista e tregjeve të përfshira në Rregulloren e AKEP është sipas rekomandimit të KE-së të vitit 2007, ndërsa rekomandimi i fundit në fuqi i KE-së është Rekomandimi (EU) 2020/2245, datë 18 dhjetor 2020. Rregullorja për Analizën e tregut do të rishikohet në kuadër të miratimit të ligjit të ri 54/2024, si edhe akteve rregullatore të miratuara nga BEREC.
27. Bazuar në rregulloren Nr. 9, datë 17.07.2009 "Për Analizën e tregut", e ndryshuar, AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse të kësaj rregulloreje si tregje të mundshme për ndërhyrje *ex-ante* në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike, *inter alias*:
- ***Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse.*** Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve kombëtare nga rrjetet fikse është pjesë e listës së tregjeve të përcaktuar në rregulloren 9/2009 dhe listës së tregjeve në rekomandimin e KE të vitit 2014 dhe pjesë e analizave të mëparshme të realizuara nga AKEP, si i tillë për analizën e këtij tregu nuk është e nevojshme kryerja e testit të tre kritereve.
 - Ndërsa për tregje të tjera të cilat nuk janë pjesë e listës së tregjeve dhe Rekomandimit të fundit të KE-së, AKEP mbart detyrimin e aplikimit të testit të 3 kritereve. Në këtë dokument është aplikuar testi i 3 kritereve për ***tregun me shumicë të tranzitimit të thirrjeve kombëtare nga vendndodhje fikse.***
28. AKEP, duke marrë në konsideratë rrethanat kombëtare harton dokumentin e analizës për shërbimet e komunikimeve elektronike dhe përcakton tregjet përkatëse, dhe në vijim të kësaj analize përcakton nëse në këto tregje ka konkurrencë efektive. Në rastet kur AKEP evidenton se një apo më shumë sipërmarrës ka/kanë Fuqi të Ndjeshme në Treg, atëherë ai vendos masat e nevojshme, të njohura si kushtet dhe detyrimet për sipërmarrësin/sipërmarrësit e përcaktuar me FNT, me qëllim adresimin/parandalimin e problematikave të tregut.
29. Gjatë këtij procesi, AKEP ushtron të drejtën e tij në rregullimin e këtij sektori specifik si rregullatori i vetëm i pavarur në Republikën e Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare. AKEP i ushtron funksionet e tij në mbështetje të ligjit nr. 54/2024, "*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*", dhe akteve të tjera rregullatore të miratuara nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Linjës, Këshilli Drejtues i AKEP, si edhe duke marrë në konsideratë direktivat, rregulloret dhe rekomandimet e Komisionit Evropian në fuqi.
30. Neni 90 i ligjit 54/2024 parashikon se kur AKEP-i pas kryerjes së procesit të analizës së tregut përkatës, gjykon se faktet që justifikuan përfundimet e arritura për përcaktimin dhe analizën e tregjeve (analizat pararendëse), kanë ndryshuar dhe nuk pasqyrojnë situatën

aktuale në treg, atëherë AKEP-i heq detyrimet e vendosura ndaj sipërmarrësit në tregun përkatës, duke siguruar që palët e ndikuara nga ky vendim të njoftohen në një periudhë të përshtatshme kohore..

II.1 Analiza e tregjeve përkatëse sipas praktikës së Komisionit Evropian

31. Ligji 54/2024 është i përafruar pjesërisht me Direktivën (BE) 2018/1972, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”. dhe metodologjia e analizës së tregjeve e përcaktuar në Ligj dhe në Rregullore, përcakton se AKEP duhet të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Evropian dhe BEREC. Disa nga Rekomandimet dhe udhëzimet e KE dhe BEREC të marra në konsideratë nga AKEP në përgatitjen e këtij dokumenti janë si më poshtë:
- a. Udhëzimi i Komisionit (evropian) për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (në vijim referuar si Udhëzimi i KE)²;
 - b. Dokumenti i rishikuar i ERG³ për Qëndrim të përbashkët në qasjen ndaj masave rregullore të duhura në kuadrin rregullator të komunikimeve elektronike;
 - c. Rekomandimi i Komisionit, datë 7 Maj 2009 për trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjete celulare dhe fikse në BE;
 - d. Rekomandimi i Komisionit, datë 9 Tetor 2014 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2014/710/EC);
 - e. Udhëzuesin e rishikuar të Komisionit Evropian për përcaktimin e sipërmarrësve me FNT (SMP guidelines FLTEEP20180015 - May 6, 2018).
 - f. Direktiva (EU) 2018/1972 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (EU) 2018/1972 për miratimin e Kodit të Komunikimeve Elektronike Evropiane (EECC);
 - g. Rregullore e Komisionit 2021/654 (Commission Delegated Regulation (EU) 2021/654);
 - h. Rekomandimin e Komisionit Evropian (EU) 2020/2245, datë 18 Dhjetor 2020 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën (EU) 2018/1972.
32. Udhëzimet dhe parimet e mishëruara në dokumentin e mjeteve juridike të BEREC-it synojnë të nxisin zhvillimin e tregut të vetëm për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, si dhe të bëjnë të mundur një praktikë rregullore uniforme dhe konsistente në shtetet e ndryshme anëtare. Sipas legjislacionit të KE një sipërmarrës përcaktohet me FNT nëse një ose më shumë ndërmarrje kanë fuqi ekonomike, që i/u jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose

² Official Journal of the European Communities C 165/7: “Commission guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the Community regulatory framework for electronic communications networks and services (2002/C 165/03)”

³ ERG (06) 33 “Revised ERG Common Position on the approach to Appropriate remedies in the ECNS regulatory framework” Final Version May 2006.

kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.

33. Në rekomandimin e vitit 2014, numri i tregjeve të dyshuar për ndërhyrje *ex ante* është reduktuar në 5, nga 7 që ishte në vitin 2007, dhe në vitin 2020 nga kjo listë kanë mbetur vetëm dy tregje. Në vijim paraqitet tabela me evoluimin e listës së tregjeve të përcaktuara për rregullim *ex ante* nga Komisioni Evropian, nga viti 2007 e deri në vitin 2020.

Tabela 1: Ndryshimet e listës së tregjeve nën rregullim në BE

Lista tregjeve nën rregullim 2007	Lista tregjeve nën rregullim 2014	Lista tregjeve nën rregullim 2020
Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse (3)	Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse (1) i pandryshuar	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile (7)	Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile (2) i pandryshuar	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse (4)	Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse WLA (3a) rishikuar	Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse WLA (3a) rishikuar
Tregun me shumicë të aksesit broadband (5)	Tregun me shumicë të aksesit broadband WCA (3b) rishikuar	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qera (6)	Tregun me shumicë të aksesit me shpejtësi të lartë nga vendndodhje fikse (4) rishikuar	Tregun me shumicë të dedikuar nga vendndodhje fikse
Tregun me pakicë të aksesit në rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse (1)	Hequr nga lista	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik (2)	Hequr nga lista	Hequr nga lista

34. KE më 7 Maj 2018 ka miratuar udhëzimin e ri për analizën e tregut dhe FNT “*Guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the EU regulatory framework for electronic communications networks and services*” (2018/C 159/01), që zëvendëson Udhëzimin e vitit 2002. Ky udhëzim është marrë në konsideratë nga AKEP në hartimin e këtij dokumenti për këshillimin publik.
35. Tregjet e terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë fikse dhe asaj mobile janë hequr nga lista e tregjeve nën rregullim nga BE nën argumentimin se këto tregje kanë tendencë të shkojnë drejt konkurrencës efektive si rezultat i vendosjes së tarifës së vetme për terminimin e thirrjeve zanore nga rrjetet fikse dhe mobile (*single maximum EU-level wholesale rates for fixed and mobile voice termination (F/MTRs)*).
36. Udhëzimi për FNT (KE) e përcakton në mënyrë të qartë që përcaktimi i tregut përkatës nuk është një proces mekanik apo abstrakt. Ai kërkon një analizë të detajuar të gjithë të dhënave të disponueshme për ecurinë dhe sjelljen në treg në të kaluarën dhe një kuptim gjithëpërfshirës të mekanizmave dhe funksionimi të tregut në të tashmen. Për sa kohë analiza e tregut është një proces i cili synon përmirësimin e kushteve të tregut në të ardhmen (Forward looking), udhëzimet për FNT e përcaktojnë në mënyrë të qartë që rregullatori duhet të evidentojë nëse tregu është konkurrues ose jo, dhe në këtë mënyrë nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës efektive, duke marrë në konsideratë parashikimet për zhvillimet e ardhshme të pritshme të tregut gjatë një periudhe të arsyeshme, të marrë masat përkatëse për evitimin e pengesave dhe kufizimeve të konkurrencës efektive.
37. Udhëzimi për përcaktimin me FNT përshkruan se si metodologjia e legjislacionit të konkurrencës mund të përdoret nga rregullatorët e telekomunikacionit në analizat e tyre. Në

veçanti, janë dy dimensione për përcaktimin e tregut përkatës: produktet përkatëse që bëjnë pjesë në të njëjtin treg dhe përcaktimi i tregut gjeografik.

II.2. Procedura e Analizës së Tregut të zhvilluar nga AKEP

38. AKEP për përcaktimin e tregut përkatës përdor përkufizimin e dhënë në nenin 3, pika 7 të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar: *“Treg përkatës - janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tyre, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”*.
39. Ky përkufizim i Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, është i ngjashëm dhe në linjë me përkufizimin e dhënë në Udhëzimin e KE (EU regulatory framework for electronic communications networks and services of 7 May 2018 (2018/C 159/01), udhëzim i përdorur nga AKEP (ERT) në të gjitha analizat e mëparshme. Për këto arsye, si dhe duke qenë se udhëzimi i KE, është pjesë e dokumenteve të KE të referuara në Rregullore për analizën e tregut, AKEP në këtë analizë përdor të njëjtën metodologji për përcaktimin e produkteve/shërbimeve që janë pjesë e të njëjtit treg përkatës, si dhe në Analizat e tjera të tregut, siç është shtjelluar dhe në paragrafët në vijim.
40. Gjatë procesit të kryerjes së analizës së tregut, synimi kryesor i rregullatorit është që të evidentojë dhe ti përgjigjet pyetjes nëse në treg ka konkurrencë efektive? Përcaktimi i termit Fuqi e Ndjeshme në Treg është ekuivalent me konceptin e Pozitës Dominuese sipas përcaktimit që bëhet nga ligji i konkurrencës. Në thelb, kjo nënkupton që sipërmarrësi në tregun përkatës zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

Praktika e Komisionit Evropian për përcaktimin e Fuqisë së Ndjeshme në Treg

41. Sipas udhëzuesit të rishikuar të Komisionit Evropian Për Fuqinë e Ndjeshme në Treg⁴ i cili mbështetet në analizën e tregjeve të komunikimeve elektronike bazuar mbi parimet e konkurrencës, Fuqia e Ndjeshme në Treg e një sipërmarrësi (single dominance) vlerësohet kur një sipërmarrës i vetëm zotëron mbi 40 % të tregut përkatës dhe prezumohet kur zotëron mbi 50 % të tregut përkatës.

Tabela 2: Udhëzuesi i rishikuar i Komisionit Evropian Për Fuqinë e Ndjeshme në Treg

⁴ Guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the EU regulatory framework for electronic communications networks and services (2018/C 159/01)

Dominancë individuale (Single SMP)	Udhëzimi i vjetër për FNT	Udhëzimi i ri për përcaktimin FNT
Supozohet që nuk ka FNT	Poshtë 25%	Nuk ka udhëzime
Risku i FNT	Mbi 40% "Në praktikën vendimmarrëse të komisionit, dyshimet për dominancë individuale normalisht shfaqen në rastet kur një sipërmarrës gëzon pjesë tregu mbi 40%, megjithatë në disa raste Komisioni ngre dyshimet për ekzistencën e dominancës individuale edhe kur një sipërmarrës ka pjesë tregu më të vogël se 40% (pasi dominanca mund të ekzistojë edhe kur një sipërmarrës nuk posedon pjesë të mëdha tregu).	Mbi 40% "Bazuar në eksperiencat e kaluara Komisioni sugjeron se dominanca individuale nuk ka gjasa të ndodhë në rastet kur një sipërmarrës posedon më pak se 40% të tregut përkatës. Megjithatë, mund të ketë raste specifike me pjesë tregu nën këtë nivel ku konkurrentët nuk kanë mundësinë të konkurrojnë në mënyrë efektive sjelljen e një sipërmarrësi dominant.
Supozohet që ka FNT	Mbi 50%	Mbi 50%

Burimi: European Commission issues revised SMP guidelines 6 May 2018 dhe Cullen International

42. Përcaktimi i Fuqisë së Ndjeshme në Treg është dhënë në nenin 88 të ligjit 54/2024, ku përcaktohen kriteret kryesore që duhet merren në konsideratë për analizën për FNT, duke bërë një ndarje për rastet kur në treg dyshohet për një sipërmarrës me FNT, që do të thotë dominancë individuale dhe për raste kur dyshohet për më shumë se një sipërmarrës me FNT apo dominancë e bashkuar, në këtë nen citohet se:

"Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse i vetëm ose së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson sipërmarrësit një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit fundorë të tij.". Ky përcaktim është i njëjtë edhe me përcaktimin në ligjin pararendës të komunikimeve elektronike 9918/2008, i ndryshuar.

43. Referenca e dhënë në nenin 88 të ligjit 54/2024, është i njëjtë me përkufizimin e Kodit të Komunikimeve Elektronike Evropiane neni 63, pika 2⁵ (Directive (EU) 2018/1972).

44. Për të bërë vlerësimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, AKEP-i bazohet, ndërmjet të tjerave, në kriteret e mëposhtme:

- në madhësinë e sipërmarrësit, madhësinë e sipërmarrësit në raport me tregun përkatës, si edhe me ndryshimet në kohë, në pozicionin relativ të tij ndaj lojtarëve të tregut;*
- në pengesat e larta për hyrje në treg dhe zgjerimi i pritshëm, si rrjedhojë e konkurrencës së mundshme;*
- në fuqinë kundërvepruese të blerësve;*
- në zhvillimin e elasticitetit ndërmjet kërkesës dhe ofertës;*
- fazat e zhvillimit të tregut përkatës;*
- përparësitë teknologjike;*
- çdo zhvillim i rrjeteve të shitjes dhe shpërndarjes;*
- ekonomitë e shkallës ose ekonomitë e sektorit dhe dendësisë;*
- shkallën e integritetit vertikal;*
- shkallën e produkteve të diferencuara;*
- aksesin në burimet financiare;*
- kontrollin për infrastrukturën që nuk mund të zëvendësohet lehtësisht;*

⁵ "An undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, namely a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors, customers and ultimately consumers"

m) sjelljet e përgjithshme në treg, si: tarifat, politikat e marketingut, shërbimet dhe produktet e kufizuara ose vendosja e pengesave.

45. Nëse në përfundim të procesit të analizës së tregut përkatës, AKEP konkludon se një apo më shumë sipërmarrës janë përcaktuar me FNT në tregun përkatës, atëherë AKEP sipas përcaktimeve të nenit 90 të ligjit 54/2024 dhe në referencë me nenin 92 të këtij ligji, vendos, ndryshon, mban ose heq masat rregullatore të parashikuara në këtë proces analize.

Në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve secili operator i rrjetit të telefonisë individuale të ofruar nga vendndodhje fikse është me fuqi të ndjeshme në treg pasi është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet.

46. Në zbatim të parashikimeve të nenit 44 dhe 45 të Ligjit 54/2024 AKEP zhvillon një procedurë transparente të konsultimi publik me palët e interesuara për dokumentet e analizës së tregut në një proces dinamik duke publikuar në mënyrë të plotë informacionet dhe qëndrimet e tij rreth analizës së tregjeve përkatëse, operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg dhe masat rregullatore të propozuara, përfshirë dhe rregullimin e tarifës së terminimit, duke vendosur si afat një periudhë kohore prej jo më pak se 30 ditësh. Ky dokument publikohet në faqen e Internetit të AKEP dhe palët e interesuara mund të dërgojnë komente në lidhje mbi përfundimet dhe propozimet e AKEP duke iu referuar pyetjeve të këshillimit publik në Aneks 1, si dhe për çdo aspekt tjetër të lidhur me këtë dokument.
47. Për efekt të transparencës, pas përfundimit të procedurës së këshillimit publik dhe miratimit të dokumentit përfundimtar komentet e palëve të interesuara (përfshirë ato konfidenciale) do të publikohen nga AKEP, së bashku me dokumentin final të analizës së tregut dhe vendimet për përcaktimin e sipërmarrësve me FNT dhe masat rregullatore.

II.3. Analizat e mëparshme në tregun e telefonisë fikse

48. AKEP bazuar në përcaktimet e Ligjit 9918/2008 (nenet 31 e në vijim, të Kreut VI mbi Rregullimin e konkurrencës), Rregulloren për Analizën e Tregut⁶, gjatë periudhës 2017–2018 kreu procedurën e analizës së tregut të telefonisë fikse, në përfundim të së cilës u miratuan vendimet e mëposhtme:
1. Vendimi nr. 21, datë 30.03.2018, për *“Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse -Dokumenti përfundimtar”*;
 2. Vendimi nr. 22, datë 30.03.2018, për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjet fikse”*;
 3. Vendimi nr. 23, datë 30.03.2018, për *“Përcaktimin e sipërmarrësit One Telecommunications Sh.a., sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e*

⁶“Rregullore për Analizën e Tregut” miratuar me Vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, të Këshillit Drejtues të AKEP, ndryshuar me VKD nr.2342, datë 31.07.2013.

thirrjeve në rrjetin publik One Telecommunications drejt numrave gjeografikë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”;

4. Vendimi nr. 24, datë 30.03.2018, për *“Përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”;*

Vendimet e mësipërme të AKEP përmbanin:

- Përcaktimin e Albtelecom sh.a. sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet publik telefonik të ofruara nga vendndodhje fikse dhe në tregun me shumicë të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse dhe vendosjen e masave rregullues;
- Përcaktimin e sipërmarrësve⁷ (operatorë alternativë) me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre individuale të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese;
- Përcaktimin e One Telecommunications sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik One Telecommunications drejt numrave gjeografikë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese.

49. Në lidhje me statusin e FNT të Albtelecom për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve, AKEP ne vitin 2018 vendosi detyrimet e mëposhtme:

- *Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39);*
- *Detyrimi i transparencës (Neni 40);*
- *Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);*
- *Detyrimi për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto (Neni 45).*

50. Masat rregulluese ndaj operatorëve Alternativë dhe të One Telecommunications (One Telecommunications fikse) për FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre në vitin 2018 janë:

- *Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39);*
- *Detyrimi i transparencës (Neni 40);*
- *Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);*
- *Detyrimi për kontroll tarife dhe orientim në kosto (neni 45).*

*Detyrimet për këta operatorë nuk përfshijnë publikim të RIO-s, si dhe një sërë detyrimesh të tjera të vendosura ndaj Albtelecom. Detyrimi i kontrollit të tarifës përfshin rregullimin nga AKEP të tarifave të terminimit të operatorëve alternativë.

⁷ Sipërmarrësit e shpallur me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre janë paraqitur në Listë në Aneksin 1 të Vendimit Nr.24, datë 30.03.2018.

II.4 Praktika e BEREC dhe AKEP për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet fikse

51. Ky kre përmban informacion mbi dokumentet e KE dhe BEREC që kanë lidhje me tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse. Në seksionin e parë përshkruhen elementët kryesorë të rekomandimeve të KE për tarifat e terminimit, ndërsa seksionet e tjera përmbajnë informacion në lidhje me tarifat e terminimit në vendet e BE dhe BEREC, rajon, si edhe krahasime të këtyre tarifave me tarifat e terminimit në Shqipëri.

II.4.1 Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe propozimi i KE 2016 për rishikimin e kuadrit rregullator

52. Komisioni Evropian (BEREC) në dokumente të ndryshëm ndër vite në lidhje me rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare, Komisioni Evropian në rekomandimin për orientimin në kosto të tarifave të terminimit, *Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare në BE (2009/396/EC)*, u ka rekomanduar autoriteteve rregullatore, midis të tjerave:
- Përcaktimin e tarifave të terminimit bazuar në kostot e ofrimit nga një operator eficient. Kjo nënkupton gjithashtu që tarifat duhet të jenë simetrike. Për përcaktimin e shkallës minimale të eficiencës për operatorët fiks, rregullatorët duhet të marrin në konsideratë faktin që në rrjetet fikse operatorët kanë mundësinë të ndërtojnë rrjetet e tyre në zona të veçanta gjeografike dhe të fokusohen në rrugëzimet me densitet të lartë dhe/ose të marrin me qira inputet përkatëse të rrjetit nga operatorët *incumbent*;
 - Vlerësimi i kostove eficientë të bazohet në kostot korente dhe përdorimin kostove afatgjatë inkrementale me metodën BU, si metodologjia e duhur e kostove;
 - Rregullatorët mund të përdorin krahasimin e rezultateve të modelit BU me model TD, i cili përdor të dhëna të audituara për të përmirësuar konsistencën e rezultateve dhe mund të bëjnë rregullimet e nevojshme;
 - Si inkrement të përdoret shërbimi me shumicë i terminimit që i shitet operatorëve të tjerë dhe jo gjithë shërbimet si në rastin LRIC+;
 - Asimetri mund të përdoret në raste kur mund të demonstrohet se hyrësit e rinj kanë disavantazh në raport me operatorët e tjerë;
 - Vendet që nuk kanë mundësi për aplikim modeli kostosh LRIC të pastër mund të përdorin metodën benchmark duke iu referuar vlerave në vendet që kanë aplikuar modelin LRIC të pastër.
53. Zgjedhjet e dhëna nga KE në këtë rekomandim kanë ndikim në rezultatet e modeleve BULRIC të aplikuar më parë dhe modeli i llogaritjes së kostove me zgjedhjet e përfshira në këtë rekomandim tashme njihet si LRIC i pastër (pure LRIC). Ky rekomandim është zbatuar gjerësisht tashmë në vendet e BE dhe rajonit.

II.4.2. Rishikimi i kuadrit rregullator të komunikimeve elektronike në BE

54. KE, nëpërmjet dokumentit të datës 11.10.2018, Directive (EU) 2018/1972 “*Directive of the European Parliament and of the Council establishing the European Electronic Communications Code*”, ka caktuar BEREC që të hartojë një set masash rregullatore dhe udhëzime në funksion të Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike.
55. Në përputhje me parashikimet e nenit 75 të Kodit të Komunikimeve Elektronike Evropiane (EECC) Komisioni Evropian, duke marrë në konsideratë opinionin e BEREC, në përputhje edhe me parashikimet e nenit 117 të EECC, ka përshtatur një akt për të mbështetur këtë direktivë për vendosjen e një tarife të vetme maksimale për secilin nga shërbimet e terminimit të thirrjeve zanore nga rrjetet fikse dhe ato mobile, të cilat do të vendosen në të gjithë ofruesit e këtyre shërbimeve në të gjitha vendet anëtare të BE.
56. Kodi gjithashtu parashikon në nenet 75 (2) dhe 75 (3) që Komisioni duhet të rishikojë Rregulloren e Deleguar çdo pesë vjet, dhe në secilën rast të tillë të marrë parasysh nëse vendosja e tarifave të vetme maksimale të terminimit për thirrjet zanore në nivel Unioni mbetet e domosdoshme duke zbatuar kriteret e listuara në nenin 67 (1).
57. Autoritetet Rregullatore të vendeve anëtarë (NRAs), pas hyrjes në fuqi të tarifave, nuk do të mund të vendosin masa rregullatore për kontrollin e tarifave për shërbimet celulare ose fikse në territorin e tyre kombëtar, por mund të përdorin vetëm instrumentin e masave të palidhura me rregullimin e tarifave/çmimeve (*non-price related obligation on the termination providers*).
58. Në përputhje me parashikimet e mësipërme, KE ka miratuar Rregulloren (Delegated Regulation) 2021/654, datë 18.12.2020 “Mbështetje e Direktivës (EU) 2018/1972”. Kjo rregullore, ndër të tjera, përcakton detyrimin për aplikimin e një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve celulare (MTR) dhe një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve nga rrjetet fikse (FTR) dhe do të jenë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha vendet e BE.

II.4.3. Tarifat mesatare të terminimit fiks në vendet e BE/BEREC


59. BEREC ka kryer publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të vendeve që bëjnë pjesë në BEREC. Në listën e vendeve që publikon BEREC aktualisht përfshihen 37 vende ku bëjnë pjesë 28 vendet anëtare të BE, vendet e zonës EEA dhe disa vende me statusin kandidat për anëtar në BE. Publikimet bëhen çdo gjashtë muaj dhe dokumenti i fundit i publikuar nga BEREC i përket datës 9 dhjetor 2021, dokumenti BoR (21) 159 “*Termination rates at European level-30 June 2021*” 9 December 2021,⁸ i cili paraqet situatën e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) më 1 korrik 2018. Dokumenti i BEREC, përveç nivelit mesatar të tarifave të terminimit, përmban informacion të detajuar edhe për tarifatat sipas operatorëve në çdo vend dhe

⁸https://www.berec.europa.eu/sites/default/files/files/document_register_store/2021/12/BoR_%2821%29_159_Termination_Rates_Report_-_30_June_2021_P4_2021_clean.pdf

metodën e aplikuar për rregullimin e tarifës së terminimit celular, përfshirë aplikimin e LRIC të pastër si dhe ‘glide path’ të parashikuar nga autoritetet rregullatore përkatëse.

60. Figura e mëposhtme përmban informacion mbi tarifën benchmark të FTR në vendet e BE/BEREC deri në korrik 2021 sipas dokumentit më të fundit të BEREC BoR (21) 159 “Termination rates at European level-June 2021” 9 December 2021⁹.

Figura 1: Tarifat FTR të terminimit në rrjetet fiks incumbent BEREC Qershor 2021 (eurocent/min)



Burimi: BEREC, BoR (21) 159, dhjetor 2021

61. Siç mund të vihet re nga figurat e mësipërme, në shumicën e vendeve aplikohet një tarifë e vetme për FTR (një segment) megjithatë ka vende që aplikojnë më shumë se një segment. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Rregullores së Komisionit Evropian 2021/654, në mbështetje të parashikimeve të Kodit të Komunikimeve Elektronike Evropiane, që nga 1 Korrik 2021 shumë vende të BE kanë filluar aplikimin e tarifës së përbashkët të terminimit FTR të përcaktuar në këtë rregullore. Duke filluar nga data 1.01.2022, norma maksimale FTR e përbashkët që aplikohet në vendet e Bashkimit Evropian është 0.07 eurocent/min, e cila është rreth 64% më e ulët se tarifa mesatare e FTR 0.1970 eurocent/min për 27 vendet e BE-së të 30.06.2021.

62. Referuar të dhënave të raportit BEREC të datës 9 Dhjetor 2021, 23 vende kanë aplikuar modelin e kostove “Pure LRIC” për rregullimin e tarifave të terminimit FTR në rrjetet fikse, 8 vende kanë përdorur metodën Benchmarking (përfshirë Shqipërinë) për rregullimin e FTR-ve, ku 5 nga këto vende kanë aplikuar metodën Benchmarking të bazuar në modelin Pure BU LRIC. Tarifat e këtyre vendeve janë përcaktuar nga rregullatorët përkatëse në momente të ndryshme kohore duke përdorur informacionin e disponueshëm për aplikimin e modelit Pure BU-LRIC në vendet e tjera Evropiane/BE.

63. Në zbatim të parashikimeve të Kodit të ri të Komunikimeve Elektronike Evropiane, Komisioni Evropian miratoi Rregulloren e Deleguar 2021/654, datë 18.12.2020, për implementimin e një tarife maksimale të përbashkët terminimi në të gjithë Bashkimin

⁹ <https://www.berec.europa.eu/en/document-categories/berec/reports/report-on-termination-rates-at-the-european-level-30-june-2021>

Evropian. Sipas kësaj Rregullore, që nga data 1 korrik 2021 ka filluar implementimi i tarifave të përbashkëta të terminimit në vendet e BE-së në vlerën 0.07 eurocent për minutë.

64. Rregullorja 2021/654 për 12 vende anëtare të BE-së ka parashikuar një periudhë tranzitore për implementimin e tarifës së terminimit fiks sipas së cilës është paraparë që zbatimi i eurotarifës (0.07 eurocent) për terminimin e thirrjeve fikse do të fillojë në vitin 2022.

Tabela 3: Tarifat tranzitore të terminimit për disa nga vendet e BE-së

Periudha	1 Korrik – 31 Dhjetor 2021	2022
<i>EU-wide cap</i>	<i>0.07</i>	<i>0.07</i>
<i>Austria</i>	<i>0.089</i>	<i>0.07</i>
<i>Belgjika</i>	<i>0.093</i>	<i>0.07</i>
<i>Kroacia</i>	<i>HRK 0.0057 (0.08 €cents)</i>	<i>0.07</i>
<i>Republika Çeke</i>	<i>CZK 0.0264 (0.11 €cents)</i>	<i>0.07</i>
<i>Finlanda</i>	<i>0.111</i>	<i>0.07</i>
<i>Letonia</i>	<i>0.076</i>	<i>0.07</i>
<i>Lituania</i>	<i>0.072</i>	<i>0.07</i>
<i>Luxembourg</i>	<i>0.110</i>	<i>0.07</i>
<i>Holanda</i>	<i>0.111</i>	<i>0.07</i>
<i>Poloni</i>	<i>PLN 0.005 (0.12 €cents)</i> <i>Initially PLN 0.0164 (0.38 €cents)</i>	<i>0.07</i>
<i>Rumania</i>	<i>0.078</i>	<i>0.07</i>
<i>Sllovakia</i>	<i>0.078</i>	<i>0.07</i>

Burimi: Cullen International

65. Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga AKEP mbi tarifën e terminimit të thirrjeve fikse në vendet e rajonit në vitin 2024, vërehet se FTR e Maqedonisë së Veriut është 0.58 eurocent/min, Serbia e ka FTR 0.09 eurocent/min, Mali i Zi aplikon MTR në vlerën 0.26 eurocent/min, Kosova aplikon FTR 0.33 eurocent/min, ndërkohë FTR e Shqipërisë me kursin mestar të këmbimit për vitin 2024 llogaritet në vlerën 0.69¹⁰ eurocent/min.

¹⁰ Kursi vjetor i këmbimit 1 euro = 100.7 lekë

Tabela 4: Tarifat e terminimit fiks ne vendet e rajonit (Eurocent/min)

<i>Vendet e Rajonit</i>	<i>01.01.2024 - 30.06.2024</i>	<i>01.07.2024 - 31.10.2024</i>	<i>01.11.2024 - 30.06.2025</i>	<i>01.07.2025 - 31.10.2025</i>	<i>01.11.2025 - 30.06.2026</i>	<i>01.07.2026 - vazhdim</i>
Kosova	0.66	0.33	0.33	0.23	0.23	0.13
Mali i Zi	0.26	0.26	0.16	0.16	0.07	0.07
Serbia	0.09	0.09	0.09	0.09	0.09	0.09
Maqedonia e Veriut	0.58	0.58				

66. Rregullorja e Komisionit Evropian ka përcaktuar se kjo tarifë do të aplikohet vetëm për trafikun e telefonisë fikse me shumicë të origjinuar brenda Bashkimit Evropian dhe vendeve të zonës EEA (Europen Economic Area) ku përfshihen edhe Islanda, Liktenshtajn dhe Norvegjia. Megjithatë, tarifat e përcaktuara në rregullore mund të aplikohen edhe për thirrjet e origjinuara jashtë kësaj zone, në rastet kur:

- Një operator i cili nuk operon në zonën EEA zbaton tarifa terminimi të njëjta apo më të ulëta se eurotarifa përgjatë gjithë vitit dhe në të gjitha shtetet e EEA;
- Për sa i përket rastit në nivel rregullimi kombëtar për një vend jashtë BE-së, rregullorja parashikon rregullim nga ky vend të terminimit në përputhje me parimet e ekuivalente me metodën BU-LRIC (shiko përcaktimet e nenit 75 dhe Aneks II i EECC).

II.4.4. Praktika e rregullimit sipas benchmark të BEREC nga AKEP

67. Tabela e mëposhtme paraqet tarifat mesatare të thjeshta për 27 vendet e BE dhe vlerën mesatare të thjeshtë të tarifave të terminimit në 37 vendet që raportojnë në BEREC deri në datë 30.06.2021, si dhe krahasimin me tarifat aktuale të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse në Shqipëri:

Tabela 5: Tarifat mesatare të thjeshta të terminimit për vendet e BEREC¹¹ Shqipëri dhe rajon

<i>Vendet e BE-së</i>		<i>Shqipëri</i>		<i>Mesatarja e rajonit¹²</i>	
<i>Eurocent/min</i>	<i>Lek/min</i>	<i>Eurocent/min</i>	<i>Lek/min</i>	<i>Eurocent/min</i>	<i>Lek/min</i>
0.07	0.072	0.69	0.70	0.337	0.227

Burimi: Të dhëna nga BEREC dhe rregullatorët e rajonit. Përpunimi AKEP


68. Nga të dhënat e paraqitura sa më sipër vërehet se tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet telefonike fikse në Shqipëri janë dukshëm më të larta se ato të vendeve të BEREC, si për mesataren e thjeshtë të 37 vendeve ashtu edhe për atë të 27 vendeve të BE. Gjithashtu, tarifa aktuale e terminimit fiks FTR në Shqipëri është shumë herë më e lartë në krahasim me tarifën e përbashkët të terminimit FTR 0.07 eurocent/min e implementuar në vendet e BE.

¹¹ BoR(21)159 "Termination rates at European level – 30 June 2021"

¹² Vendet e rajonit të marra si referencë: Kosova, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut

69. Referuar të dhënave të raportit BEREC të datës 9 Dhjetor 2021, 23 vende kanë aplikuar modelin e kostove “Pure LRIC” për rregullimin e tarifave të terminimit FTR në rrjetet fikse, 8 vende kanë përdorur metodën Benchmarking (përfshirë Shqipërinë) për rregullimin e FTR-ve, ku 5 nga këto vende kanë aplikuar metodën Benchmarking të bazuar në modelin Pure BU LRIC. Tarifat e këtyre vendeve janë përcaktuar nga rregullatorët përkatëse në momente të ndryshme kohore duke përdorur informacionin e disponueshëm për aplikimin e modelit Pure BU-LRIC në vendet e tjera Evropiane/BE. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Rregullores së Komisionit Evropian 2021/654, që nga 1.01.2022 shumë vende të BE kanë filluar aplikimin e FTR-ve sipas vlerave të *glidepath* të përcaktuar në këtë rregullore.
70. Në Shqipëri, duke filluar nga data 1.01.2016, AKEP ka përdorur metodën e rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark) duke përdorur një reduktim të përshkallëzuar (*glide path*), me unifikimin e tarifës së terminimit (simetrike për të gjithë operatorët fiks) në vlerën 1.48 lek/minutë deri në tarifën aktualisht në prej 0.70 lekë/min, e cila është sa tarifa mesatare (benchmark) e vendeve të BEREC që aplikojnë një segment dhe sa mesatarja e tre segmenteve në vendet e BEREC dhe BE, më 1.01.2014.

Figura 2: Ecuria e tarifave FTR për Shqipërinë 2016-2024



Burimi: AKEP

71. Në kushtet në të cilën ndodhet tregu i telefonisë fikse në vendin tonë, në mungesë të ndërtimit të modelit BU LRIC të pastër, AKEP ka përdorur metodën e rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark). Tregu i telefonisë fikse në vendin tonë karakterizohet nga:
- një normë mjaft e ulët e penetrimit (rreth 6.9% për vitin 2024) krahasuar me vendet e tjera në BE dhe rajonit, norma e penetrimit në vitin 2024 u rrit lehtë krahasuar me periudhen pararendese, si pasojë e uljes së bazës së popullsisë nga të dhënat e Census 2023;
 - një rënie e ndjeshme e trafikut të thirrjeve të origjinuara nga rrjetet e telefonisë fikse në vite dhe të ardhurave respektive të sipërmarrësve të telefonisë fikse;
 - kërkesa gjithnjë e më shumë e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse, si rrjedhojë edhe e rritjes së përdorimit në masë të shërbimeve të telefonisë mobile ku përfshihen edhe përdorimi i aplikacioneve OTT.

72. Në mungesë të një modeli kostosh sipas metodës BU-LRIC, duke pasur parasysh karakteristikat e tregu të ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse në Shqipëri, si edhe argumentet e parashtruara sa më sipër AKEP propozon vijimin e rregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse duke u bazuar në metodologjinë e benchmark.

III. Tregu me pakicë i shërbimeve të telefonisë fikse

73. Bazuar në Ligjin 54/2024 “Për komunikimet elektronike në RSH”, ofrimi i rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, përveç shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarura nga numrat është subjekt i regjimit të autorizimit të përgjithshëm, duke respektuar detyrimet specifike, të përcaktuara sipas pikës 6 të nenit 28 të këtij ligji, si dhe kërkesat për pajisjen me të drejtat e përdorimit për frekuencat dhe numeracionin, sipas këtij ligji, kur ofrimi i rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike bazohet në përdorimin e burimeve natyrore të fundme.
74. Gjatë periudhës 2018 – 2024, në tregun vendas janë shënuar ndryshime të rëndësishme në tregjet e komunikimeve elektronike si në aspektin e zhvillimeve teknologjike dhe cilësisë së shërbimit, ashtu edhe në aspektin e ndryshimeve strukturore të sipërmarrësve kryesorë që ofrojnë shërbime nëpërmjet rrjeteve fikse dhe atyre mobile. Disa nga zhvillimet kryesore strukturore paraqiten si më poshtë vijon:
- a. Përfundimi i kontrollit të shoqërisë ABCOM SHPK nga shoqëria Vodafone Albania sh.a., autorizuar me vendim të Komisionit të Konkurrencës nr. 676, datë 7.2.2020. Ndryshim i cili i ka mundësuar shoqërisë Vodafone Albania të jetë tashmë një ndër konkurrentët kryesorë edhe në tregun e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve fikse;
 - b. Sipas pikës 3 të VKD 23/2020, është vendosur kalimi i detyrimeve të vendosura për FNT (Fuqi të Ndjeshme në Treg), ndaj sipërmarrësit “Abcom” sh.p.k tek sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a, në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 24, datë 30.03.2018 “Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese” dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 77, datë 01.10.2018 “Për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”.
 - c. Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 855, datë 14.1.2022 ka vendosur për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nga përfundimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom sh.a., nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt);
 - d. Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 869, datë 8.3.2022, autorizoi përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag;


- e. Këshilli Drejtues i AKEP, më anë të vendimit nr.14, datë 7.11.2022, ka miratuar transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të dhëna sipas regjimit të autorizimit individual dhe regjimit të autorizimit të përgjithshëm, si dhe për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP nga sipërmarrësi “Albtelecom sh.a.” te sipërmarrësi “One Telecommunications sh.a.”;
75. Këshilli Drejtues i AKEP, më anë të vendimit nr.15, datë 16.12.2022, ka miratuar transferimin e të drejtave të përdorimit të disa frekuencave nga sipërmarrësit “Albtelecom sh.a.” dhe “One Telecommunications sh.a.” tek sipërmarrësi “Vodafone Albania sh.a.”.
76. Si rezultat edhe i ndryshimeve të ndodhura në tregun e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, nga data 1 Janar 2023 sipërmarrësit One Albania (bashkimi i Albtelecom me One Telecommunications) dhe Vodafone Albania ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të dyja tregjet e ofrimit të shërbimeve mobile dhe fikse. Të dy këto shoqëri janë sipërmarrësit me pjesët më mëdha në tregun e ofrimit të shërbimit broadband nëpërmjet rrjeteve fikse për numër pajtimtarësh.
77. Këto ndryshime strukturore përveç impaktit në tregun e ofrimit të rrjeteve celulare pritet të kenë efekte edhe në dinamikat e tregut të ofrimit të komunikimeve elektronike nëpërmjet rrjeteve fikse, duke pasur parasysh kombinimin e kapaciteteve fikse të Albtelecom si operatori më i madh i telefonisë fikse dhe kapaciteteve të One Telecommunications.

III.1. Numri i pajtimtarëve e telefonisë fikse

78. Shërbimet e rrjeteve fikse telefoni dhe/ose internet në Shqipëri ofrohen/janë njoftuar nga rreth 251 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet infrastrukturore të tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkt me përdoruesit fundorë, nga të cilët numri i operatorëve që ofrojnë shërbimin e telefonisë fikse (të pajisur me numeracion gjeografik) është 29¹³.
79. Një pjesë e madhe e operatorëve alternativë janë të vegjël dhe me prani shumë të kufizuar rrjeti në zona urbane apo rurale afër qendrave urbane. Sipas të dhënave statistikore të depozituara në AKEP rezulton se numri i operatorëve të aktivë të rrjeteve të telefonisë fikse është 29.
80. Siç vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun në vijim numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka vijuar trendin rënës edhe përgjatë periudhës 2018 – 2024.

Figura 3: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të Telefonisë fikse 2018 – 2024

¹³ Sipas Regjistrimit të sipërmarrësve që kanë njoftuar ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm deri në datën 10.06.2025.



Burimi: Të dhënat nga operatorët. Përpunimi AKEP

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të operatorëve kryesorë të rrjeteve fikse për periudhën 2018 –2024.

Tabela 6: Ecuria e numrit te pajtimtarëve të telefonisë fikse sipas operatorëve (2018 - 2024)

	One Albania	Vodafone Albania	ASC	Abissnet	Nisatel	OA te tjere	Total
2018	177,129	11,637	40,377	4,049	4,100	11,339	248,631
2019	176,653	11,409	35,558	4,095	4,098	11,046	242,859
2020	168,142	8,524	30,399	4,154	4,122	8,128	223,469
2021	152,829	8,355	20,583	4,191	4,164	7,568	197,690
2022	143,150	7,726	11,804	4,231	4,121	6,214	177,246
2023	139,763	8,742	11,777	4,216	3,320	5,317	173,135
2024	134,176	7,203	11,809	4,336	3,456	5,317	165,380
Ndryshimi 2024/2023	-4%	-18%	0%	3%	4%	0%	-4%

Burimi: Të dhënat nga operatorët. Përpunimi AKEP

81. Gjatë periudhës 2018–2024, tregu i telefonisë fikse në Shqipëri ka përjetuar një rënie të ndjeshme dhe të vazhdueshme të numrit të pajtimtarëve. Nga rreth 249 mijë pajtimtarë në vitin 2018, ky numër ka zbritur në rreth 165 mijë në fund të vitit 2024, që përfaqëson një ulje me afërsisht 33% në harkun e gjashtë viteve. Vetëm gjatë vitit të fundit (2023–2024), rënia është rreth 4%. Ky trend reflekton zhvillimet strukturore dhe teknologjike në treg, përfshirë, zëvendësimin e telefonisë fikse me shërbime të lëvizshme dhe zgjidhje mbi rrjetet IP (VoIP), zhvillimin e rrjeteve të internetit broadband, që ofrojnë komunikim të integruar dhe më efikas, ndryshimet demografike, veçanërisht reduktimin e popullsisë, të pasqyruar pas regjistrimit të Censurit 2023, që ka ndikuar në përlllogaritjen e normës së penetrimit. Pavarësisht rënies në terma absolutë, norma e penetrimit në vitin 2024 u rrit lehtë në 6.88%, si pasojë e uljes së bazës së popullsisë. Megjithatë, kjo normë mbetet shumë më e ulët krahasuar me mesataren botërore, që është rreth 11% si dhe me vendet e zhvilluara, ku telefonia fikse ende ruan një normë përdorimi rreth 33%. Të dhënat konfirmojnë se rënia e pajtimtarëve nuk është një fenomen i përkohshëm, por një orientim afatgjatë i tregut drejt alternativave më fleksibël dhe bashkëkohore të komunikimit elektronik.
82. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse për 100 banorë në Shqipëri është dukshëm më ulët se ai në vendet e tjera të rajonit, normat më të larta të pajtimtarëve për 100 banorë për vitin


2023 janë në Serbi (37), Mal të Zi (30), në Maqedoninë e Veriut (24), e ndjekur nga Bosnja Hercegovina me (19)¹⁴.

83. Norma mesatare botërore e penetrimit të pajtimtarëve për 100 banorë që nga viti 2005 ka shënuar rënie të vazhdueshme ku nga rreth 19 që ishte në vitin 2005 ka arritur në rreth 11 në vitin 2023, ku një ndikim të rëndësishëm ka pasur rritja e vrullshme e përdorimit të telefonisë së lëvizshme, si edhe përdorimi i internetit.
84. Siç vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën sa më sipër, operatori me pjesën më të madhe në treg është One Albania rreth 81.1 %, i ndjekur nga ASC me rreth 7.1%, Vodafone me rreth 4.4%, OA të tjerë me 5.3% dhe Nisatel me 2.1%. Pavarësisht se numri i pajtimtarëve të telefonisë ka shënuar rënie të vazhdueshme pesha e pjesës së tregut të pajtimtarëve të One Albania ka vazhduar të rritet që nga viti 2018 e në vazhdim, kjo si rrjedhojë e normës së rënies më të lartë të operatorëve të tjerë. Ajo që konstatohet është se për vitin 2024 pjesa e pajtimtarëve për operatorët kryesor ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2023, ndërkohë që ASC ka shënuar një rritje të lehtë dhe Nisatel ka pasur rritje me rreth 4%.
85. Aktualisht ASC është operatori alternativ me numrin më të madh të linjave të telefonisë fikse, i cili ka pasur të njëjtin nivel gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023. Vlen të vihet në dukje se një pjesë e konsiderueshme e pajtimtarëve të shërbimeve nga rrjete fikse janë përdorues të paketave të integruara, që përfshijnë Internetin broadband fiks dhe IPTV si shërbim kryesor, ndërsa përdorimi i telefonisë fikse është shumë i ulët.

Ndaria Gjeografike

86. Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 55% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale është e madhe.

Figura 4: Norma e penetrimit të telefonisë fikse sipas qarqeve (2024)



Burimi: Të dhënat të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP

87. Nga figura sa më sipër konstatohet se penetrimi i telefonisë fikse varion ndjeshëm nga njëri Qark në tjetrin. Qarku me normën më të lartë të penetrimit të linjave fikse është Tirana

¹⁴ <https://data.worldbank.org/indicator/IT.MLT.MAIN.P2?end=2023&locations=RS-AL-BA-ME-MK&start=2005&view=chart>

12.4%, i ndjekur nga Gjirokastra dhe Vlora përkatësisht me 11% dhe 8.1%. Qarqet me normën më të ulët të penetrimit të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse për 100 banorë Dibra, Elbasani, Fieri, Kukësi dhe Shkodra të cilat janë nën normën 4%.

Tabela 7: Numri i linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe operatorëve (2024)


Qarku	Total	One Albania	Vodafone	ASC	OA të tjerë
Berat	6,350	6,169	80	0	101
Dibër	2,174	2,172	1	1	0
Durrës	12,213	11,121	167	281	644
Elbasan	6,033	5,952	70	3	8
Gjirokastrë	6,577	6,503	14	0	60
Fier	5,012	4,505	241	6	260
Korçë	12,094	11,029	818	133	114
Kukës	2,237	2,236	0	0	1
Lezhë	4,287	4,209	15	10	53
Shkodër	5,598	4,709	225	0	664
Tiranë	90,877	67,027	5,420	11,367	7,063
Vlorë	11,928	8,544	152	8	3,224

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

88. Nga të dhënat e tabelës më sipër evidentohet se One Albania është operatori i vetëm me shtrirje të rrjetit në të gjitha qarqet e vendit, si edhe zotëron një pjesë të konsiderueshme të infrastrukturës kombëtare për ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse. Operatorët e tjerë, janë të përqendruar në qarqet më të mëdha të vendit, kryesisht zonat me densitet të lartë të popullsisë.

89. Figura në vijim paraqet penetrimin e telefonisë fikse për vendet e rajonit Bosnje Hercegovinë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Shqipëria gjatë viteve 2015-2023.

Figura 5: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse për 100 banorë 2015-2023



Burimi: Banka Botërore


90. Nga të dhënat e paraqitura në figurën sa më sipër, vërehet se penetrimi i telefonisë fikse në Shqipëri është dukshëm më ulët se ai në vendet e tjera të rajonit, normat më të larta të pajtimtarëve për 100 banorë për vitin 2023 janë në Serbi e ndjekur nga Mali i Zi.

III.2 Trafiku telefonik i pajtimtarëve

91. Përpos rënies së numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse, rënie konstatohet edhe në përdorimin e shërbimeve të telefonisë fikse ku sasia totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse në vitin 2024 shënoi rënie me 11% krahasuar me vitin 2023, si rrjedhojë e rënies së sasisë së thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të One Albania, ndërkohë që rënia është dukshëm më e madhe nëse marrim në konsideratë krahasimin e volumit të minutave të thirrjeve dalëse të vitit 2024 me vitin 2019, ku vërehet një ulje me rreth 70% të këtij treguesi.
92. Gjithashtu, mesatarja e minutave të thirrjeve në muaj për përdorues të rrjetit fiks One Albania është ulur nga rreth 35 minuta në vitin 2019 në 10 minuta në vitin 2024. Rënia e vazhdueshme e trafikut të telefonisë fikse duhet parë në kontekstin e faktoreve të lidhur me: migrimin e përdoruesve drejt rrjeteve celulare, të cilat ofrojnë fleksibilitet, akses më të gjerë dhe tarifa konkurruese; zëvendësimin të thirrjeve zanore tradicionale me aplikacione komunikimi përmes internetit (VoIP, aplikacione OTT si WhatsApp, Viber, etj.); ndryshimeve në stilin e jetesës dhe sjelljes komunikative, ku përdoruesit përfitojnë nga natyra gjithnjë e më e integruar e shërbimeve celulare dhe internetit.

Figura në vijim paraqet ecurinë e trafikut të origjinuar të telefonisë fikse dhe trafikun e origjinuar nga telefonia celulare përgjatë viteve 2018 – 2024.

Figura 6: Ecuria e thirrjeve nga rrjetet fikse dhe celulare 2018-2024



Burimi: Të dhënat nga operatorët. Përpunimi AKEP

93. Bazuar në të dhënat sa më sipër, vërehet një diferencë e theksuar në volumin e thirrjeve dalëse nga operatorët celularë, përkundrajt thirrjeve dalëse nga rrjetet telefonik fiks. Rënia e volumit të thirrjeve është një fenomen që ka ndodhur për të dy grupet e operatorëve, si ato të telefonisë fikse ashtu edhe ato mobile, fenomen ky i ngjashëm edhe me vendet e tjera, ndikuar edhe nga rritja e komunikimit nëpërmjet aplikacioneve që përdorin internetin për realizimin e thirrjeve audio dhe video.
94. Volumi i thirrjeve të origjinuara nga rrjetet e telefonisë fikse ka pësuar një rënie të ndjeshme në periudhën 2018–2024, duke reflektuar prirjen në rënie të përdorimit të këtij shërbimi. Nga

rreth 106 milionë minuta në vitin 2018, volumi i thirrjeve dalëse ka rënë në rreth 27 milionë minuta në vitin 2024, çka përbën një rënie prej afërsisht 75%. Rënia ka qenë graduale dhe e vazhdueshme, me nivele si: rreth 88 milionë minuta në vitin 2019, rreth 84 milionë në 2020, 86 milionë në 2021, 43 milionë në 2022 dhe 30 milionë në 2023. Kjo tendencë dëshmon për një zhvendosje të qartë të përdoruesve drejt shërbimeve alternative të komunikimit, si telefonja celulare dhe platformat digjitale. Më poshtë jepet një tabelë krahasuese me vlerat vjetore dhe përqindjen e rënies vjetore së bashku me rënie totale kumulative për të pasur një panoramë më të qartë të ndryshimeve:


Tabela 8: Volumi i minutave të origjinuara nga rrjetet e telefonisë fikse

Viti	Minuta totale (milionë) (të përafërta)	Ndryshimi vjetor (%)	Rënie kumulative nga 2018 (%)
2018	106	–	0%
2019	88	-17%	-17%
2020	84	-4.5%	-20%
2021	86	2.4%	-19%
2022	43	-50%	-59%
2023	30	-30%	-72%
2024	27	-10%	-75%

Burimi: Të dhënat nga operatorët. Përpunimi AKEP

Grafikisht paraqitet ne vijim rënia progresive të volumit të thirrjeve dalëse nga rrjetet fikse në periudhën 2018–2024.

Figura 7: Ecuria e volumit të thirrjeve dalëse nga rrjetet fikse



Burimi: Të dhënat nga operatorët. Përpunimi AKEP

95. One Albania ka ruajtur pjesën më të madhe të tregut për thirrjet dalëse në telefoninë fikse, si rrjedhojë e bazës më të madhe të pajtimtarëve, por ashtu si operatorët e tjerë, edhe ky operator ka regjistruar një rënie të vazhdueshme të volumit të trafikut në këtë segment. Ecuria e pjesëve të tregut për trafikun dalës të One Albania nga 2018 deri në vitin 2024, ka pësuar rënie nga 86% në 2018 në 62% pjesë tregu në vitin 2024. Ndërsa pjesa tjetër e tregut për thirrjet dalëse i përket operatorëve të tjerë të telefonisë fikse, ku në tërësinë e tyre reflektohet rënie e trafikut dalës nga rrjetet e tyre. Në harkun kohor të referuar më sipër, veçanërisht në periudhën 2020-2024, Vodafone Albania ka shënuar një rritje të pjesëve të tregut nga viti

2020 deri në 2024 (nga 7% në rreth 13% në vitin 2024) periudhe kohore në të cilën është realizuar dhe bashkimi me përthithje nga Vodafone për operatorin Abcom.

96. Rënia e konsiderueshme e trafikut të origjinuar nga rrjetet e operatorëve të telefonisë fikse dhe asaj mobile gjatë viteve të fundit vjen edhe si rrjedhojë e rritjes së përdorimit në masë të aplikacioneve OTT, c'ka impakton direkt volumin e thirrjeve të gjeneruara nga operatorët e telefonisë fikse dhe mobile.

III.3 Tarifimi i shërbimeve me pakicë të rrjeteve fikse

97. Tendencat në tarifimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në Shqipëri kanë ndjekur tendencat globale të përqendrimit të paketave tarifore/ofertave të operatorëve drejt paketave me shërbime të integruara, si për përfshirje të sasive të caktuara të minuta të thirrjeve në pagesë fikse mujore dhe/ose për kombinime me të paktën dy shërbime (paketa të integruara që përfshin shërbimet Telefoni+Internet+TV) kundrejt pagesës fikse mujore.
98. Nga analiza e të dhënave të raportuara dhe monitoruara nga AKEP gjatë viteve të fundit ndër të tjera vërehet se:
- Tendenca e operatorëve të telefonisë fikse ka qenë promovimi i paketave tarifore me përfshirje minutash thirrje telefonike në pajtim mujor (bundles of minutes) si dhe kombinim të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit në Internet (bundles of services). Operatorët më të mëdhenj alternative të telefonisë fikse si Vodafone Albania, ASC, Abissnet, apo edhe operatorët e tjerë, janë ofrues të shërbimeve akses në internet, telefoni dhe transmetim të shërbimeve televizive, dhe ofrojnë dhe paketa të integruara me të tre shërbimet në një shportë dhe me tarifë mujore të përbashkët.
 - Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU)¹⁵ ka publikuar treguesit e ICT për vitin 2024 raport në të cilin përfshihet edhe Shqipëria. Në këtë raport, paraqiten në mënyrë të përmbledhur renditja e vendeve të ndryshme të botës në lidhje me informacionin dhe teknologjitë e komunikimit të matur në tre dimensione të ndryshme (Vlera në dollar, indeksi GNI në % dhe fuqisë blerëse - PPP) ku pjesë është edhe shporta me “Fixed-broadband shporta me 5GB”. Sipas këtij raporti për vitin 2024¹⁶ Shqipëria renditet në vendin e 91 (me një çmim rreth 17.09\$), renditje e cila është përkeqësuar krahasuar me vendin e 82 në vitin 2023, dhe akoma më shumë me vendin e 47 në vitin 2022, dhe me vendin e 48 në vitin 2021.
 - Edhe në raport me vendet e rajonit Bosnje Hercegovinë, Mali i Zi dhe Serbi, shporta minimale e ofruar në Shqipëri renditet më dobët, vetëm Maqedonia e Veriut renditet pas Shqipërisë për këtë shportë përkatësisht në vendin e 93.
 - Operatorët alternative në Shqipëri kanë tarifa pajtimi mujor për shërbimet e rrjeteve fikse shpesh më të ulët se operatorët kryesorë për t’ju mundësuar konkurrueshmëri në këtë treg.

¹⁵ <https://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Dashboards/Pages/IPB.aspx>

¹⁶ Ndryshimi i madh në renditje ka ndodhur në vitin 2023 dhe për shkak edhe të efekteve në kursin e këmbimit, kjo renditje është përkeqësuar në vitin 2024.

Karakteristike tjetër e operatoreve alternative është ofrimi falas i thirrjeve brenda rrjetit (të përfshira në pagesën mujore).

- Paketa standarde “Familjare” është një ndër opsionet e paketave tarifore të One Albania, pasi ky operator ofron një sërë paketash tarifore dhe opsione (shporta me minuta) dhe shporta të integruara me dy, tre apo katër shërbime të komunikimeve elektronike, thirrje telefonike, akses ne Internet, IPTV dhe telefoni celular.
- Çmimet e paketave vetëm ofrim të shërbimeve të telefonisë fikse të One Albania fillojnë nga 300 lekë për paketat ‘Fix Extra’ dhe arrijnë deri në 1,500 lekë në muaj për planin ‘FolFiks Super’, natyrisht këto paketa kanë në përmbajtën e tyre minuta dhe njësi komunikimi të ndryshme në varësi të çmimit.
- Vodafone Albania ofron shërbimin e telefonisë fikse pagesa për të cilin fillon nga 100 lekë (mirëmbajtje mujore) nëpërmjet të cilës mund të marrësh thirrje hyrëse por nuk mund të kryhen telefonata, duke vijuar me mundësitë rimbushëse me kredite komunikimi me vlerë 500 lekë ose 1000 lekë kohë bisede për të kryer telefonata drejt çdo destinacioni.
- Përqendrimi në shërbimet e integruara dhe alternativat tarifore të sipërmarrësve që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike nga rrjetet fikse tregojnë për rritje të fleksibilitetit dhe inovacionit në ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe shërbimeve të reja në kushtet e rritjes së presionit konkurrues në treg, si nga rrjetet fikse dhe nga ato celulare;
- Shtimi i njësive të komunikimit nëpërmjet rrjeteve celulare ofruar paketa me përmbajtje internet, minuta dhe sms pa limit vitet e fundit ka rritur në masë të madhe efektin zëvendësues të thirrjeve nga rrjete fikse me thirrje nga rrjete celulare, fenomen i cili është ndikuar edhe nga përdorimi i internetit mobile për kryerjen e thirrjeve zanore nëpërmjet aplikacioneve OTT.

Paketat e integruara ne rrjetet fikse

99. Rrjetet fikse kryesisht janë të orientuara drejt shërbimeve të integruara, gjë e cila reflektohet zhvendosja nga telefoni tek shërbimet broadband-i dhe kjo evidentohet nga fakti që gjatë periudhës 2019–2024, shërbimi tradicional i telefonisë fikse ka humbur funksionin qendror që dikur kishte në rrjetet fikse, duke u shndërruar në një komponent dytësor brenda paketave të integruara të shërbimeve.
100. Të dhënat statistikore tregojnë qartë se zhvillimi i rrjeteve fikse në Shqipëri është i drejtuar kryesisht nga kërkesa për akses broadband dhe sidomos nga paketat e integruara të shërbimeve, të cilat përfshijnë kombinime të aksesit në internet, TV dhe telefonisë fikse. Në fund të vitit 2024, numri i pajtimtarëve që përdorin paketa të integruara (dyfishe ose trefishe) arriti në rreth 300 mijë, duke shënuar një rritje të lehtë prej 2% krahasuar me vitin 2023. Kjo formë ofrimi shërbimesh ka dominuar konkurrencën midis operatorëve, pasi ofron vlerë të shtuar për përdoruesit përmes komoditetit dhe përfitimeve të çmimeve të kombinuara. Në një vlerësim të strukturës së tregut të shërbimeve të integruara në 2024, konstatohet se: 43% e pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse janë abonentë të paketave të integruara, që tregon një prirje të fortë drejt konsolidimit të konsumit në një zgjidhje të vetme komunikimi.

Brenda këtij grupi, 23% kanë zgjedhur paketa trefishe që përfshijnë telefoninë fikse, internetin dhe shërbimet televizive (TV). Të dhënat nga viti 2019 deri në 2024 tregojnë se ndërkohë që numri total i pajtimtarëve me paketa të integruara ka qenë relativisht i qëndrueshëm, struktura e preferencave ka ndryshuar:

101. Në një përmbledhje të këtij konstatimi mund të evidentohet se: Paketat Internet + TV janë në rritje të vazhdueshme dhe përfaqësojnë aktualisht segmentin më të madh brenda tregut të shërbimeve të integruara (me mbi 141 mijë pajtimtarë në 2024); Ndërsa numri i pajtimtarëve me paketa trefishe ka pësuar rënie të ndjeshme që prej vitit 2019, duke reflektuar rënien e rëndësisë së telefonisë fikse në këto oferta; Segmenti Telefoni + Internet, megjithëse më i qëndrueshëm, nuk ka shënuar rritje domethënëse. Përdoruesit po i orientojnë gjithnjë e më shumë nevojat e tyre të komunikimit dhe navigimi përmes internetit dhe televizionit, ndërkohë që telefonia fikse mbetet kryesisht si shërbim komplementar ose i përfshirë për arsye praktike apo tarifore brenda paketave.

Tabela 9: Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (2019-2024)

	Totali	Telefoni fikse dhe Internet	Telefoni fikse, Internet dhe TV	Internet dhe TV
2019	267,584	86,352	109,773	71,459
2020	294,587	89,953	102,870	101,764
2021	302,596	82,746	91,689	128,161
2022	312,674	89,904	72,255	150,515
2023	295,296	89,091	69,534	136,671
2024	300,123	89,545	69,575	141,003
Ndryshim v-m-v	2%	1%	0%	3%

Burimi: Të dhënat nga operatorët. Përpunimi AKEP

102. Të dhënat për vitin 2024 tregojnë se paketat e integruara të shërbimeve në rrjetet fikse vijnë të jenë një formë dominuese e konsumit, megjithëse me ritme të moderuara të rritjes. Numri i pajtimtarëve me paketa “triple play” (që përfshijnë telefoninë fikse, internetin dhe TV-në) mbeti praktikisht i pandryshuar krahasuar me vitin 2023, duke reflektuar një ngopje të mundshme të tregut për këtë tipologji shërbimi ose interes të ulët për komponentin e telefonisë fikse. Ndërkohë, paketat “double play” që përfshijnë internet dhe TV u rritën me rreth 3% gjatë vitit 2024, duke u konfirmuar si forma më e përhapur e konsumit të shërbimeve të integruara. Kjo rritje tregon orientimin e vazhdueshëm të përdoruesve drejt shërbimeve të lidhura me aksesin në përmbajtje digjitale dhe argëtim, në një mjedis ku interneti dhe TV-ja janë komponentët kryesorë të përdorimit të përditshëm. Gjithashtu, edhe paketat që përfshijnë telefoninë fikse dhe internetin shënuan një rritje modeste prej rreth 1%, duke treguar një qëndrueshmëri të lehtë në këtë segment, por që mbetet më pak tërheqës krahasuar me ofertat që përfshijnë shërbimet televizive.
103. Për sa më lart mund të thuhet se: Tendenca kryesore, gjatë vitit 2024 konfirmon vijimin e tendencës së viteve të fundit ku telefonia fikse ka humbur peshën dominuese, ndërkohë që shërbimet broadband dhe TV janë kthyer në shtyllat kryesore të ofertave të operatorëve të rrjeteve fikse. Kjo orienton gjithnjë e më shumë zhvillimin e tregut drejt paketave të fokusuara në përmbajtje dhe shpejtësi interneti, me telefoninë fikse që mbetet më tepër një shtesë teknike ose tarifore, sesa një kërkesë reale nga përdoruesit.

104. Gjatë viteve të fundit, është konstatuar edhe lançimi i paketave promocionale që të ofrojnë përfitime në paketat e ofruara nga rrjetet fikse si edhe në paketat e telefonisë celulare, duke ofruar kështu shërbimet ‘Quad Play’. Shoqëria One Albania ka hedhur në treg paketë promocionale që ofron përfitime nga kombinimi i paketave mobile dhe fikse Mix&Max¹⁷, duke ofruar shërbim “Quad Play”. Edhe Vodafone Albania ofron në treg paketë të kombinuara me shërbime fikse dhe mobile “Shtëpia Jonë”¹⁸. Nga këto kombinime, abonentët që bëhen pjesë e këtyre planeve tarifore përfitojnë zbritje në shërbimet e zgjedhura. Gjithashtu, ata mund të përzgjedhin dhe paketë TV në këtë kombinim. Pajtimtarët marrin një faturë të vetme për të gjitha shërbimet mobile dhe fikse.

Akresi broadband nga rrjete fikse

105. Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2024 tejkaloi shifrën e 693 mijë pajtimtarëve, duke u rritur me rreth 10% në krahasim me vitin 2023.

Tabela 10: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit Broadband nga rrjete fikse 2019-2024

	One Albania	Vodafone Albania	Abissnet	ASC	Nisatel	Digicom	OA të tjerë	Total
2019	133,515	74,708	40,849	52,773	13,809	18,516	102,022	436,192
2020	128,877	95,558	41,576	58,529	17,609	22,400	144,388	508,937
2021	118,130	111,072	42,338	59,275	20,586	24,850	183,143	559,394
2022	113,197	126,115	43,175	60,282	22,386	27,097	193,033	585,285
2023	139,318	127,733	43,284	61,332	24,480	31,987	204,625	632,759
2024	152,107	144,494	44,960	61,579	28,529	34,715	227,599	693,983
Ndryshimi 2024/2023	9%	13%	4%	0%	17%	9%	11%	10%

Burimi: Të dhënat nga operatorët. Përpunimi AKEP

106. Bazuar në të dhënat e raportuara, për vitin 2024 operatorët me pjesët më të mëdha të tregut broadband fiks për sa i përket treguesit të numrit të pajtimtarëve paraqiten si më poshtë vijon:

- One Albania zotëron rreth 22% pjesë tregu;
- Vodafone Albania zotëron rreth 21% pjesë tregu;
- A.S.C zotëron rreth 9% pjesë tregu;
- Abissnet me rreth 6% pjesë tregu;
- Digicom zotëron rreth 5% pjesë tregu;
- Nisatel zotëron rreth 4% pjesë tregu;
- OA (operator të tjerë), me rreth 33% të tregut.

III.4. Përdorimi mesatar i thirrjeve telefonike fikse

107. Ndër faktorët e marrë në konsideratë për de-rregullimin e tregut me pakicë të telefonisë fikse në analizë 2015, ishte dhe efekti zëvendësues i thirrjeve nga rrjete fikse me ato nga rrjete celulare. Për këtë AKEP ka shqyrtuar jo vetëm ecurinë e trafikut total të origjinuar nga rrjetet

¹⁷ <https://promo.one.al/mixnmax>

¹⁸ <https://www.vodafone.al/shtepia-jone/>

fiks dhe celulare (seksionet më sipër) por edhe ecurinë e nivelit mesatar të përdorimit të thirrjeve telefonike nga rrjete fikse dhe celulare në periudhën 2019-2024. Në tabelat e mëposhtme, paraqiten treguesit e përdorimit mesatarë mujore nga rrjeti One Albania fiks dhe nga rrjetet celulare për periudhën 2019-2024.

Tabela 11: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike nga rrjet fiks i One Albania 2019-2024

	2019	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023
Thirrje dalëse	35	33	37	18	12	10	-17%
Thirrje të marra	54	54	48	36	27	22	-19%
MOU	89	87	85	54	39	32	-18%

Tabela 12: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike celulare 2019-2024

	2019	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023
Thirrje dalëse	171	168	178	154	132	133	0%
Thirrje të marra	177	174	182	157	135	138	1%
MOU	348	342	360	311	268	271	2%


Burimi: Të dhënat nga operatorët. Përpunimi AKEP

108. Të dhënat për përdorimin mujor mesatar të thirrjeve telefonike në rrjetin fiks të One Albania për periudhën 2019–2024 tregojnë një tendencë të qëndrueshme dhe të thellë në rënie, duke reflektuar zhvendosjen progresive të përdoruesve nga shërbimet tradicionale të telefonisë fikse drejt formave të tjera të komunikimit (p.sh., aplikacionet OTT, telefonja celulare, mesazhet online). Nga evidencat dhe llogaritjet e vlerësuara nga AKEP, rezultojnë se: Thirrjet dalëse ranë nga një mesatare prej 35 minutash në muaj në vitin 2019 në vetëm 10 minuta në 2024, çka përfaqëson një ulje me rreth 71% gjatë gjithë periudhës pesëvjeçare; Thirrjet e marra gjithashtu pësuan një rënie të ndjeshme, nga 54 minuta në 2019 në 22 minuta në 2024, me një ulje totale prej 59%. Konsumi total mesatar mujor për përdorues (MOU) u përgjysmua dhe më tepër, nga 89 minuta në 2019 në vetëm 32 minuta në 2024 (rënie prej 64%). Vetëm në vitin 2024, përdorimi i thirrjeve dalëse ra me 17% dhe thirrjet e marra me 19% në raport me vitin paraardhës. Konsumi total (MOU) shënoi gjithashtu një rënie me 18%, duke treguar një dobësim të vazhdueshëm të interesit të përdoruesve për përdorimin e telefonisë fikse edhe në rastet kur ata e disponojnë këtë shërbim si pjesë të një pakete të integruar.

109. Figura e mëposhtme paraqet në mënyrë grafike ecurinë e përdorimit mesatar të thirrjeve dalëse nga rrjeti fiks i One Albania dhe rrjetet celulare në 2019-2024, ku vihet re tendencat e kundërta midis këtyre dy treguesve për periudhën deri në vitin 2020: thirrjet dalëse për

përdorues në rrjetin fiks janë në rënie, ndërkohë që thirrjet dalëse për përdorues nga rrjetet celulare kanë tendencë rritje. Ndërsa në vitin 2021 kemi tendencë të njëjtë në rritje si të thirrjeve dalëse për përdorues në rrjetin fiks dhe të thirrjeve dalëse për përdorues nga rrjetet celulare. Për periudhën 2021 - 2024 kemi një rënie të të dy llojeve të thirrjeve dalëse për përdorues si në rrjetin fiks ashtu dhe në atë celular.

Figura 8: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike dalëse Albtelecom fiks vs celular 2019-2024



Burimi: Të dhënat nga operatorët. Përpunimi AKEP

110. Për sa më sipër, AKEP vlerëson se efekti zëvendësues i thirrjeve telefonike fikse me thirrje telefonike celulare ka vijuar për periudhën 2019 – 2024 dhe pritët të vijojë të jetë i qëndrueshëm edhe në vitet në vijim, ndonëse me ritme më të ulëta. Por, duhet theksuar se edhe volumi i thirrjeve celulare në vetvete ka pësuar rënie të ndjeshme gjatë viteve të fundit, kryesisht si efekt i rritjes së përdorimit të aplikacioneve OTT që përdorin internetin celular. Mund të thuhet se telefonia fikse ka kaluar nga një shërbim bazë në një funksion thuajse gjithnjë e më pak i përdorshëm për shumicën e përdoruesve dhe me rënie të vazhdueshme. Kjo tendencë reflektohet nga ndryshimet në sjelljen e konsumatorit, që preferon komunikimin përmes internetit (VoIP, aplikacione OTT), nga zëvendësimin e telefonisë fikse nga telefonia celulare si mjet kryesor komunikimi, por edhe nga rënia e vlerës shtuar që përdoruesit i atribuojnë telefonisë fikse, edhe kur ajo ofrohet si pjesë e paketave “triple play”.


III.5. Portabiliteti i numrit Fiks

111. Ky shërbim për telefoninë fikse filloi të ofrohet prej muajit Shtator 2012. Kjo lehtësi i krijon mundësinë pajtimtarëve të operatorëve të telefonisë fikse që të bartin numrin e tyre fiks drejt operatorit që ata vlerësojnë si më atraktiv për shërbimet telefonike fikse, pa ndryshuar numrin e telefonit. Ashtu si edhe portabiliteti i numrit celular, implementimi i portabilitetit të numrit fiks ka rritur konkurrencën midis operatorëve dhe përfitimet e përdoruesve fundorë.

112. Nga të dhënat e portabilitetit të numrit fiks për periudhën 2018 – 2024 rezulton se numri total i numrave të portuar është rreth 6,231 numra telefonik fiks, ku siç vërehet numri më i lartë i

portimeve të numrave fiks gjatë kësaj periudhe ka qenë në vitin 2018 me 2,233 portime, ndërkohë gjatë periudhës 2019 – 2022 numri i portimeve të numrave të telefonisë fikse është luhatur në nivelet 800 – 900 numra në vit, dhe veçanërisht gjatë dy viteve të fundit 2023 dhe 2024 numri i portimeve është reduktuar ndjeshëm respektivisht në 329 gjatë vitit 2023 dhe 173 në vitin 2024.

Figura 9: Ecuria e vëllimit të numrave të portuar 2018-2024



Burimi: Të dhënat nga sistemi i portabilitetit.

113. Përgjatë periudhës së marrë në analizë, operatori One Albania (ish Albtelecom) ka qenë operatori dhënës më i madh, ndërkohë Vodafone Albania Sh.a. ishte operatori marrës më i madh. Vlen të theksohet, se portabiliteti i numrave të rrjeteve fikse ka ardhur në rënie të dukshme, fakt i cili i atribuohet edhe uljes së numrit të pajtimtarëve që përdorin telefoninë fikse, ku gjatë kësaj periudhe ky numër është reduktuar me rreth 33%.

III.7. Pjesët e Tregut dhe Tregues financiarë

Pjesët e tregut

114. Në vijim paraqitet një informacion krahasues i pjesëve të tregut të sipërmarrësit One Albania (ish Albtelecom) sh.a me operatorët e tjerë kryesorë të tregut të telefonisë fikse, kjo duke konsideruar se ky operator ndër vite ka mbajtur pjesën më të madhe të këtij tregu.

115. Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e pjesëve të tregut për numër pajtimtarësh të telefonisë fikse të One Albania dhe operatorëve alternativë për periudhën 2019-2024.

Tabela 13: Pjesët e tregut të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse (2019-2024)

	One Albania	Vodafone Albania	ASC	OA të tjerë
2019	72.74%	4.70%	14.64%	7.92%
2020	75.24%	3.81%	13.60%	7.34%
2021	77.31%	4.23%	10.41%	8.05%
2022	80.76%	4.36%	6.66%	8.22%
2023	80.72%	5.05%	6.80%	7.42%
2024	81.13%	4.36%	7.14%	7.37%

Burimi: Të dhënat nga operatorët. Përpunimi AKEP

116. Siç vërehet nga të dhënat sa më sipër, për vitin 2024 operatori me pjesën më të madhe në treg vazhdon të jetë One Albania me rreth 80.7%, i ndjekur nga ASC me rreth 7.14%, Vodafone Albania me rreth 4.4%, dhe operatorët e tjerë me 7.4%. Ajo që konstatohet është se pavarësisht se pjesa e tregut të One Albania në përqindje ka pësuar rritje, rënia e numrit të pajtimtarëve të këtij shërbimi ka qenë në ulje të vazhdueshme edhe për këtë sipërmarrës.

117. Ne tabelën e mëposhtme paraqiten pjesët e tregut për pajtimtarë, thirrjet telefonike dalëse dhe të ardhurat totale nga rrjeti fiks i Albtelecom për periudhën 2019-2024.

Tabela 14: Ecuria e pjesëve të tregut të One Albania 2019-2024

	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Pajtimtarë telefoni fikse	176,653	168,142	152,829	143,150	139,763	134,176

Burimi: Të dhënat nga One Albania. Përpunimi AKEP

118. Pavarësisht se pesha e tregut të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të One Albania luhetet në kufijtë e 80% të pjesës së këtij tregu, numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse të One Albania ka shënuar rënie të vazhdueshme, duke arritur në nivelin më të ulët në vitin 2024 me rreth 134 mijë pajtimtarë.

Pjesët e tregut sipas treguesve financiarë


119. Gjatë vitit 2024, rreth 78% e të ardhurave të këtij tregu janë gjeneruar nga 6 sipërmarrës kryesorë, konkretisht: One Albania (26%), Vodafone sh.a (24%), ASC (8%), Digicom (6%), Abissnet (6%), Nisatel (4%), ndërsa operatorët e tjerë alternativë (OA) kanë gjeneruar rreth 24% të të ardhurave të këtij tregu. Në krahasim me vitin 2023 vihet re një renie e dukshme e One Albania me rreth 26 %, një rritje në peshën e të ardhurave nga Vodafone Albania me 4.5 %, rritje me 13 % nga ASC, rritje me 39 % nga Abisnet ndërsa operatorët e tjerë një rritje rreth 12.6 %.

Tabela 15: Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve elektronike nga rrjetet fikse për operatorët kryesorë 2019-2024 (milion ALL)

	2019	2020	2021	2022	2023	2024	Ndryshimi 2024/2023
One Albania fiks	3958	3910	3688	3331	4078	3020	- 26%
Vodafone fiks	1502	1674	2603	2676	2648	2768	4.5%
ASC	605	648	713	743	787	890	13%
Digicom	279	385	486	591	621	675	8.6%
Abissnet	416	423	438	464	496	691	39%
Nisatel	264	319	391	422	404	434	7.4%
OA të tjerë	2148	2212	3403	4541	2815	2797	12.6%

Burimi: Të dhëna nga operatorët. Përpunimi AKEP

Figura 10: Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve elektronike nga rrjetet fikse për operatorët kryesorë (milionë lek)



120. Të dhënat e tabelës, tregojnë qartë tendencat e të ardhurave për secilin operator nga viti 2019 deri në 2024, ku mund të evidentohet, se One Albania (fiks) tregon një rënie të dukshme në 2024 pas një rikuperimi të përkohshëm në 2023; Vodafone (fiks) ka pasur një rritje të qëndrueshme, duke mbajtur një trend pozitiv; ASC, Digicom, dhe Abissnet tregojnë rritje të fortë dhe të qëndrueshme, veçanërisht Abissnet në 2024; Operatorët e tjerë (OA të tjerë) kanë pasur luhatje të forta, me një kulm në 2022 dhe një rënie të ndjeshme më pas.

121. Në një analizë dhe vlerësim të të ardhurave nga shërbimet fikse për periudhën 2019–2024, konstatohet se periudha 2019–2024 ka reflektuar dinamika të ndryshme për operatorët kryesorë që ofrojnë shërbime elektronike në rrjetet fikse. Disa operatorë kanë njohur rritje të qëndrueshme të të ardhurave, ndërsa të tjerë kanë përjetuar rënie të ndjeshme. Kjo tregon një treg në evolucion të vazhdueshëm, ku pozicionimi strategjik dhe investimet në infrastrukturë kanë ndikuar drejtpërdrejt në performancën ekonomike të subjekteve.

122. Tregu i shërbimeve fikse po diversifikohet dhe po rristrukturohet, me një tendencë të qartë në favor të operatorëve alternativë më të vegjël (Digicom, Abissnet, ASC), të cilët po fitojnë terren falë ofertave fleksibile dhe investimeve në teknologji të re. Operatorët më të mëdhenj tradicionalë si One Albania janë përballur me sfida që lidhen me mbajtjen e pjesës së tregut dhe rentabilitetin në kushte konkurruese. Rritja e vazhdueshme e Vodafone dhe ASC tregon strategji efektive për integrimin e shërbimeve fikse dhe mobile dhe zhvillimin e infrastrukturës.

123. One Albania (fiks) ka regjistruar një rënie të konsiderueshme të të ardhurave gjatë periudhës, nga 3,958 milionë ALL në vitin 2019 në 3,020 milionë ALL në 2024. Kjo përkthehet në një rënie mesatare vjetore prej -5.5%, me një rënie të thellë prej -26% vetëm në vitin 2024 krahasuar me 2023, duke reflektuar një humbje të pozicionit në treg. Vodafone Albania (fiks) ka treguar një trend rritës të qëndrueshëm, me të ardhurat që janë rritur nga 1,502 milionë ALL në 2019 në 2,768 milionë ALL në 2024. Kjo përfaqëson një rritje mesatare vjetore prej 13.6%, me Vodafone Albania ka shënuar rritje vjetore më të moderuar në vitin 2024 prej rreth 4.5%. ASC ka ndjekur një trajektore pozitive të rritjes, duke e rritur të ardhurat me 13% vetëm në vitin 2024 dhe me një rritje mesatare vjetore prej 8.1% gjatë gjithë periudhës, duke arritur nga 605 milionë ALL në 2019 në 890 milionë ALL në 2024. Digicom ka pasur një


rritje të qëndrueshme, me të ardhura që janë më shumë se dyfishuar, nga 279 milionë ALL në 2019 në 675 milionë ALL në 2024. Rritja mesatare vjetore ka qenë 19.4%, e nxitur nga zgjerimi i kapilaritetit të rrjetit dhe ofertave të personalizuar. Abissnet ka shënuar rritjen më të lartë në vitin 2024 me 39%, duke reflektuar një zgjerim agresiv në treg. Të ardhurat janë rritur nga 416 milionë ALL në 2019 në 691 milionë ALL në 2024, me një rritje mesatare vjetore 10.6%. Nisatel ka ruajtur një trend të qëndrueshëm rritës, me një rritje mesatare prej 10.5%, duke kaluar nga 264 milionë ALL në 2019 në 434 milionë ALL në 2024. Operatorët e tjerë (OA të tjerë) kanë paraqitur një tendencë të paqëndrueshme. Pas një kulmi në vitin 2022 (4,541 milionë ALL), të ardhurat ranë ndjeshëm në 2023 dhe mbetën të qëndrueshme në 2024 (2,797 milionë ALL). Rritja mesatare për këtë grup rezulton 5.5%, por me variacione të forta ndër vite që tregojnë ndryshime strukturore apo dalje/hyrje operatorësh në këtë segment.

124. Për të dhënat e paraqitura në tabelën sa më sipër duhet të sqarojmë se të ardhurat e sipërmarrësve janë të ardhurat e gjeneruara për të gjitha shërbimet e rrjeteve fikse që ata ofrojnë, ku peshën më të madhe e zënë të ardhurat nga ofrimi i shërbimit internet dhe paketat e kombinuara. Ndërkohë që të ardhurat nga terminimi i thirrjeve fikse në këto rrjete zënë një peshë mjaft të vogël.

Të ardhurat nga shërbimet fikse në vitin 2024

Të ardhurat e sipërmarrësve nga shërbimet/rrjetet fikse në vitin 2024 ishin afërsisht 11.6 miliardë lekë, duke pësuar rënie me rreth 2% nga periudha pararendëse, rënie e cila është diktuar nga rënia e të ardhurave të sipërmarrësit One Albania nga rrjetet fikse me rreth 1 miliardë lekë.

Figura 11: Pjesë e tregut për të ardhurat sipas operatorëve kryesorë fikse në 2024



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

125. Bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën më sipër, vërehet se në tregun e rrjeteve fikse në vitin 2024, krahasuar edhe me vitin pararendës 2023, konstatohet një stabilitet relativ në të ardhura. Gjatë vitit 2024, të ardhurat totale të raportuara nga ofruesit e rrjeteve dhe shërbimeve fikse arritën në rreth 11.6 miliardë lekë, duke reflektuar një rënie të lehtë prej

rreth 2% krahasuar me vitin 2023. Kjo rënie është ndikuar kryesisht nga tkurrja e të ardhurave të One Albania me rreth 1 miliard lekë, që ka ndikuar ndjeshëm totalin, për shkak të pjesës së lartë që ky operator mban në treg. Operatorët kryesorë me ndikim në të ardhurat nga rrjetet fikse, paraqesin një dinamike ku mund të vlerësohet se, të ardhurat vijnë të jenë të dominuara nga operatorët e mëdhenj dhe të mesëm, të cilët përbëjnë rreth 78% të totalit të të ardhurave në sektorin e rrjeteve fikse. One Albania mban pozicionin e liderit të tregut me rreth 26% të të ardhurave me gjithë rënien vjetore në vitin 2024, duke u ndjekur nga Vodafone Albania me rreth 24%. Operatorët e tjerë kryesorë qëndrojnë në intervalin 3–8%, duke treguar një strukturë tregu me koncentrim të moderuar, por me hapësirë për konkurrencë.

126. Një tregues tjetër që duhet konsideruar lidhet me investimet dhe fokusi në orientim drejt rrjeteve moderne. Nga të dhënat konstatohet se Investimet në rrjetet fikse në 2024 kapën vlerën e 2.89 miliardë lekëve, me një rritje të lehtë krahasuar me 2.75 miliardë lekë në 2023. Rreth 87% e këtyre investimeve janë fokusuar në rritjen e aksesit broadband, me theks të veçantë në zhvendosjen nga teknologjia DSL drejt rrjeteve me fibër, duke reflektuar orientimin e tregut drejt cilësisë së lartë dhe kapaciteteve të mëdha të transmetimit.
127. Për sa sipër mund të konkludohet se në kushtet e tranzicionit të tregut të rrjeteve fikse, megjithëse të ardhurat janë në rënie për disa operatorë kryesorë, strukturat e investimeve dhe orientimi drejt teknologjive moderne si fibra optike po i japin tregut një karakter më të qëndrueshëm dhe konkurrues. Kjo sinjalizon përparimin gradual drejt një infrastrukture më moderne dhe të përshtatur me nevojat aktuale të konsumatorëve.
128. Përgjatë vitit 2024, sipërmarrësit e rrjeteve fikse kanë kryer rreth 2.89 miliardë lekë investime në rrjetet e tyre duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2023 ku kjo shifër ishte rreth 2.75 miliardë lekë. Sipas raportimeve, edhe në këtë vit investimet janë kanalizuar kryesisht në funksion të përmirësimit të aksesit të shërbimeve broadband rreth 87% e totalit, ku ndër investimet kryesore është fokusimi drejt zhvendosjes së rrjeteve të transmetimit nga teknologjia DSL drejt teknologjisë me fibër.
129. Tregu i shërbimeve elektronike është një ndër sektorët që ka një kontribut mjaft të rëndësishëm edhe në punësim, ku në vitin 2024 ky treg numëron më shumë se 3,300 të punësuar.

III.8. Zhvillimet strukturore të tregut nga viti 2018 dhe në vijim

130. Gjatë viteve të fundit kanë ndodhur ndryshime strukturore të lidhura me shërbimet e rrjeteve celulare dhe fikse pasi operatori Vodafone Albania Sh.A realizoi bashkimin me përthithje me sipërmarrësin e rrjeteve fikse ABCOM shpk, dhe që nga data 1 Janar 2023 u realizua bashkimi me përthithje i dy operatorëve Albtelecom sh.a dhe One Telecommunications sh.a tek operatori One Albania sh.a. Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr.23 datë 26.11.2020 vendosi “Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale të sipërmarrësit Abcom sh.p.k tek sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a”, dhe me vendimin nr.14, datë 7.11.2022 vendosi “Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP,

si dhe Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale të sipërmarrësit Albtelecom sh.a tek sipërmarrësi One Telecommunications sh.a”.

131. Me transaksionet e ndodhura gjatë këtyre viteve të fundit (bashkimit midis operatorëve Vodafone Albania sh.a me Abcom sh.p.k dhe operatorëve One Telecommunications sh.a me Albtelecom sh.a), ka ndryshuar struktura e tregut të telefonisë fikse dhe asaj celulare, me një reduktim të numrit të numrit të operatorëve të rrjeteve fikse dhe atyre celulare (nga tre në dy operatorë mobile pas bashkimit të Albtelecom dhe ONE nën kontrollin e 4iG). Operatorët Vodafone Albania dhe One Albania ofrojnë shërbime fikse dhe mobile duke qenë prezent si në tregun e telefonisë fikse ashtu dhe të telefonisë celulare.
132. Pas bashkimit të Abcom shpk me sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a pjesa e tregut të shërbimeve fikse të operatorit të bashkuar ka shënuar rritje si në drejtim të numrit të pajtimtarëve ashtu edhe të të ardhurave. Ndërkohë, numri i pajtimtarëve të shërbimit të telefonisë fikse ka pasur një tendencë të përgjithshme në rënie gjatë periudhës 2018–2022, me ulje të ndjeshme në 2019 (–25%) dhe 2022 (–8%). Pas një rritjeje prej 13% në 2023, në vitin 2024 numri i pajtimtarëve pësoi sërish rënie me 18%.
133. Për sa i përket zhvillimeve pas bashkimit të Albtelecom dhe One Telecommunications, sipas statistikave të raportuara konstatohet se One Albania ka vijuar tendencën rënëse në segmentin e telefonisë fikse edhe gjatë viteve të fundit. Në vitin 2023, numri i pajtimtarëve ra me 2% krahasuar me 2022, ndërsa në vitin 2024 kjo rënie u thellua në rreth 4%. Pavarësisht kësaj, One Albania mbetet dominuese në këtë treg, duke zotëruar 81% të tregut të telefonisë fikse, përkundrajt pjesës së vogël që mban Vodafone Albania (rreth 5%). Këto përqindje kanë mbetur pothuajse të pandryshuara që nga viti 2022, duke reflektuar një pozicion të konsoliduar të One Albania, pavarësisht rënies graduale të bazës së pajtimtarëve.
134. Për sa i përket numrit të pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse, situata është e ndryshme. One Albania ka shënuar një tendencë të përgjithshme rënëse të numrit të pajtimtarëve gjatë periudhës 2019–2022, duke pësuar një ulje prej rreth 15%. Megjithatë, në vitin 2023 ka ndodhur një rritje e konsiderueshme me rreth 23%, që sinjalizon një rikthim agresiv në treg, e ndikuar nga politikat marketing dhe investimeve në infrastrukturë kryesisht në kalimin e rrjetit në fibër. Tendencë pozitive ka vijuar edhe në vitin 2024, por më e moderuar (+9.2%).
135. Për Vodafone Albania (shërbimi internet fiks) për vitet 2019–2022, konstatohet një rritje dinamike, sidomos në 2020 (+27.9%), duke reflektuar ndoshta efektin e bashkimit me Abcom dhe zgjerimit të ofertës fikse. Në vitet 2022–2024, rritja vijon në mënyrë më të moderuar, veçanërisht në 2023 me vetëm +1.3%, por më pas në 2024 me (rritje me 13.1%).
136. Për sa vihet re më sipër, pas bashkimit të One Telecommunications me Albtelecom, ndryshimi në strukturën e tregut të telefonisë fikse dhe rritja e përqendrimit në treg nuk është reflektuar në përqendrim në nivelin e konkurrencës në treg. Niveli i konkurrencës në tregun e telefonisë fikse nuk ka shfaqur shenja të kufizimit të konkurrencës, ku ndër të tjera rol kanë luajtur edhe presioni konkurrues nga operatorët e tjerë si, ASC, Abissnet, Digicom, Nisatel, etj.

137. Vlen të nënvizohet fakti se prezenca e operatorëve Vodafone Albania dhe One Albania dhe në tregun e telefonisë mobile rrit avantazhet konkurrues të këtyre dy operatorëve ndaj operatoreve të tjerë të rrjeteve të telefonisë fikse pasi u krijohet mundësia e ofrimit të paketave/kombinimeve të përbashkëta të shërbimeve të ofruara nga rrjetet fikse dhe ato mobile.

III.9. Përfundim mbi ecurinë e tregut me pakicë të telefonisë fikse

138. Bazuar në rregulloren për Analizën e Tregut, Rekomandimin e Komisionit Evropian për nxjerrjen nga rregullimi të tregut të telefonisë fikse me pakicë, si edhe ecurinë e faktorëve të marrë në konsideratë në tregun e telefonisë dhe rrjeteve fikse, AKEP gjykon se nuk është e nevojshme që tregjet me pakicë të telefonisë fikse të jenë objekt rregullimi ‘ex-ante’, pasi faktorët që ndikuan në nxjerrjen nga rregullimi të këtyre tregjeve në vitin 2015 vijnë të jenë prezent dhe në disa raste dhe të jenë përforcuar.

139. Për sa paraqitur dhe në paragrafët më sipër, në tregun me pakicë të telefonisë fikse vihet re një tendencë në rënie e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse.

- Trendi rënës i volumit të trafikut të origjinuar në rrjetet fikse gjatë viteve të fundit evidenton një përdorim gjithnjë e më të ulët të këtij shërbimi nga pajtimtarët e telefonisë fikse. Një nga arsyet e rënies së konsiderueshme të trafikut të origjinuar nga rrjetet e operatorëve të telefonisë fikse gjatë viteve të fundit vjen edhe si rrjedhojë e rritjes së përdorimit në masë të aplikacioneve OTT. Rënia e volumit të thirrjeve është një fenomen që ka ndodhur si për operatorët e telefonisë fikse ashtu edhe ato mobile, ndikuar edhe nga rritja e komunikimit nëpërmjet aplikacioneve që përdorin internetin për realizimin e thirrjeve audio dhe video. Gjithashtu, duhet theksuar dhe rritja e efektit ‘zëvendësues’ të thirrjeve nga rrjete fikse me thirrje nga rrjete celulare, si rrjedhojë e shtimit të njësive të komunikimit nëpërmjet rrjeteve celulare ofruar paketa me përmbajtje internet, minuta dhe sms pa limit vitet e fundit.
- Një tjetër faktor që duhet theksuar është dhe ecuria e nivelit mesatar të përdorimit të thirrjeve telefonike nga rrjete fikse e cila ka pasur një trend në rënie gjatë tre viteve të fundit, përfshirë segmentin kohor objekt të kësaj analize. I njëjti trend në rënie vihet re gjithashtu edhe për thirrjet telefonike dalëse në rrjetet celulare. Një rënie e ndjeshme vihet re gjithashtu dhe në përdorimin e kartave me parapagim gjatë periudhës 2018 – 2024.

140. Analiza e kryer evidenton se aftësia dominuese e dy operatorëve kryesorë One Albania dhe Vodafone Albania në tregun e telefonisë fikse është kufizuar ndjeshëm për shkak të disa faktorëve:

- Portabiliteti i numrit fiks ka qene efektiv dhe One Albania rezulton të jetë operatori dhënës më i madh për periudhën 2017-2021, dhe Tibo operatori dhënës më i madh për vitin 2022, ndërsa Vodafone Albania Sh.a. (F) është operatori marrës më i madh Në periudhën 2022-2024 ka vijuar tendenca në rënie e portimeve të numrave fiks dhe në vitin 2024 u portuan 173 numra fiks.

- Disa operatorë alternative kanë zgjeruar zonat e ofrimit të shërbimeve duke rritur aftësitë konkurruese të tyre ndaj One Albania në prezencë edhe të masave të tjera si portabiliteti i numrit. Në shumë zona gjeografike One Albania ndeshet me konkurrencën e disa operatorëve alternativë si: Vodafone Albania, ASC, Nisatel, Abissnet, etj.;
- Evoluimi i teknologjisë dhe sjelljes konsumatore në drejtim të paketave të integruara dhe të thjeshta (me përfshirje të minutave në pagesë mujore) janë tregues se One Albania vijon të ndeshet me presion konkurrues nga operatorët e tjerë në tarifimin e shërbimeve telefonike të ofruara nga rrjetet fikse;
- Pas bashkimit të operatorëve Vodafone Albania me Abcom, dhe Albtelecom me One Telecommunications konvergjenca e shërbimeve fikse dhe celulare është rritur ndjeshëm, ku tashmë të dy operatorët mobile janë njëkohësisht edhe operatorët me peshën më të madhe edhe në ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse.

IV. Analiza e Tregjeve Përkatës me shumicë: Terminimi dhe Tranzitimi i thirrjeve ne rrjetet fikse

IV.1. Përkufizimi i tregjeve përkatëse

141. Shërbimet e interkoneksionit (terminimi dhe tranzitimi) janë analizuar në mënyrë periodike, ku edhe në këtë analizë mbart me vete aspekte teorike dhe arsyetime të trajtuara në dokumentet e analizave të mëparshme, duke mos e konsideruar të nevojshme risjelljen e të njëjtave argumente të trajtuara më parë. Për këto aspekte si dhe mbi mënyrën dhe skemën e funksionimit të shërbimeve të interkoneksionit (shërbimet e terminimit, origjinimit dhe tranzitimit) dhe ndërveprimit të tyre çdo i interesuar mund të referohet në dokumentet e mëparshme të analizave që kanë trajtuar këto shërbime.
142. Shërbimet ne nivelin me shumice janë shërbime të nevojshme për operatorët e rrjeteve fikse dhe celulare dhe ofruesit e shërbimeve që të ofrojnë shërbimet të telefonisë përdoruesve fundorë, pra në nivelin me pakicë. Në nivelin me shumicë shërbimet e nevojshme të operatorëve për të ofruar thirrje drejt rrjeteve të tjera janë origjinimi, terminimi dhe tranzitimi i thirrjeve të cilat janë elemente të nevojshme për të ofruar thirrje telefonike pajtimtarëve të rrjeteve fikse, thirrje drejt pajtimtarëve të rrjeteve fikse dhe për të vijuar thirrjet drejt këtyre pajtimtarëve. Njëkohësisht këto shërbime shërbejnë si inpute edhe për ofrimin e thirrjeve nga rrjetet celulare drejt rrjeteve fikse.
143. Shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në një rrjet fikse janë shërbime interkoneksioni të përcaktuara edhe në ofertën referencë të operatorëve fikse, si edhe Marrëveshjet e Interkoneksionit (MI) të lidhura ndërmjet operatorëve fikse, si më poshtë:
- “Shërbimi i Terminimit në rrjetin e operatorit fikse X”***
- Shërbimi nëpërmjet të cilit operatori fikse X, në emër të Operatorit përfitues përcjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit për në një Pikë fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave gjeografike të operatorit fikse X sipas planit të numeracionit.
- “Shërbimi Tranzitimit në rrjetin e operatorit fikse X”***
- Është përcjellja e thirrjeve telefonike nga operatori fikse X midis pikës së interkoneksionit me operatorin Përfitues deri në pikën e Interkoneksionit të një Operatori/Rrjet Tjetër Përfitues të cilët nuk janë të interkonektuar direkt midis tyre.
144. Terminimi dhe tranzitimi i thirrjeve në rrjetet fikse janë shërbime me shumicë, të cilët përbën një input të domosdoshëm për operatorët e rrjeteve të tjerë (fikse dhe celulare) që t’u ofrojnë thirrje përdoruesve të rrjetit të vet drejt përdoruesve të një rrjeti fikse.
145. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse, është pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP nr. 9, datë 17.7.2009 “Për Analizën e Tregut”, e ndryshuar, për këtë arsye AKEP nuk e konsideron të nevojshme të bëjë një analizë të tre kritereve nëse ky treg është treg përkatës i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante. Përkufizimi i këtij tregu si treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante është tashmë një

praktike rregullatore e konsoliduar dhe e aplikuar nga të gjithë vendet anëtare dhe kandidate të BE, si edhe me gjerë. Ndërsa tregu i tranzitimit të thirrjeve fikse është i nevojshëm kryerja e testit të tre kriterëve, pasi nuk është pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP nr. 9/2009.

146. Në të gjitha raundet e analizave të tregut të telefonisë fikse për terminimin e thirrjeve, AKEP ka përcaktuar tregje përkatëse të veçanta për terminimin e thirrjeve në secilin rrjet fiks të operatorëve aktivë në treg në periudhat përkatëse: One Albania (më parë Albtelecom), dhe operatorët e tjerë alternativë. Ndërsa për tregun e tranzitimit të thirrjeve ka përcaktuar tregun përkatës për tranzitimin e thirrjeve në rrjetin One Albania (ish Albtelecom).

147. Në analizën pararendëse AKEP ka bërë përkufizimin e tregjeve përkatës të lidhur me tregun me shumicë të telefonisë fikse dhe të justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante* si më poshtë:

- ***Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin Albtelecom, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a;***
- ***Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin publik alternativ fiks X¹⁹, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi X sh.a;***
- ***Tregu i tranzitimit të thirrjeve zanore në rrjetet fikse, shërbim i ofruar nga sipërmarrësit e rrjeteve publike fikse.***

Dimensioni gjeografik i tregjeve të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve zanore është përcaktuar zona operimit (mbulimit me rrjet) të operatorit përkatës ofrues të shërbimit territori i Republikës së Shqipërisë.

148. Për mënyrën dhe skemën e funksionimit të shërbimeve të interkoneksionit (shërbimet e terminimit, origjinimit dhe tranzitimit) dhe ndërveprimit të tyre, lexuesi mund t'i referohet dokumenteve të mëparshme të analizave të tregut. Me evoluimin dhe progresin teknologjik, rrjetet fikse tashmë kanë migruar në NGN dhe interkonektimi i shërbimeve është i bazuar në IP, si për rrjetet fikse, ashtu dhe për rrjetet celulare. Ky fakt përbën një faktor të rëndësishëm për përafrimin e tarifave të terminimit fiks dhe mobile, një tendencë kjo që evidentohet në shumë vende të BE-së.

149. Procesi i migrimit në NGN megjithëse mund të ketë efekt në segmentet e veçanta të shërbimeve (lokal/njëfish/dyfish) si dhe në mënyrën e interkonektimit me SS7 apo IP, ai nuk ka impakt në përkufizimin e tregjeve përkatës të terminimit/tranzitimit/origjinimit të thirrjeve në rrjete fikse, për sa kohe vazhdon modeli '*Calling Party Pays*'.

150. Aktualisht tregu i terminimit tarifohet në një segment të vetëm që nga 1.01.2016, ndërsa mundësia për tu interkonektuar me rrjetin e One Albania (ish Albtelecom) ekziston në dy pika interkoneksioni që nga periudha 1.01.2018.

151. Për vetë natyrën e tregjeve të terminimit (fiks dhe celulare), natyrën monopol të tyre në ofrimin e këtij shërbimi nga rrjetet të cilat posedohen nga ofruesit e këtij shërbimi, faktorët

¹⁹ Cdo sipërmarrës që është pajisur me autorizim të përgjithshëm nga AKEP për ofrimin e rrjeteve publike telefonike fikse dhe është aktiv në treg.

e cituara edhe ne analizat pararendëse mbeten te pandryshuara, ku ne tërësinë e tyre janë si me poshtë:

- ekzistojnë tregje përkatës të veçantë për terminimin e thirrjeve në çdo rrjet fiks: pra ofrimi nga secili operator rrjeti fiks i terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet;
- tregjet e origjinimi dhe tranzitimit përfshijnë ofrimin e këtyre shërbimeve nga të gjithë operatorët e rrjeteve fikse;
- tregu përkatës i terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse përfshin vetëm terminimin e thirrjeve kombëtare;
- tregu përkatës i tranzitimit të thirrjeve në rrjetet fikse përfshin vetëm tranzitimin e thirrjeve kombëtare;
- tregu i origjinimit të thirrjeve përfshin dhe vet-ofrimin (self-supply) por nuk është me treg i justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante*.

152. Për një informacion më të detajuar për përkufizimin e tregjeve përkatës të terminimit/tranzitimit/origjinimit të thirrjeve në rrjetet fikse, lexuesi mund ti referohet dokumenteve të Analizave të telefonisë fikse pararendëse duke filluar nga analiza e telefonisë fikse e vitit 2010 dhe ne vijim, të cilat gjenden të publikuara në faqen e internetit të AKEP www.akep.al.

153. Për sa më sipër, AKEP në vijim do të vlerësojë ndërhyrjet rregullatore ose jo në tregjet përkatës të interkoneksionit në rrjetet fikse dhe të justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante* si vijon:

- Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin One Albania, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi One Albania sh.a;
- Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin publik fiks të operatorit alternativ X, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi X²⁰;
- Tregu i tranzitimit të thirrjeve zanore në rrjetet fikse, shërbim i ofruar nga sipërmarrësit e rrjeteve publike fikse;

154. Dimensioni gjeografik i tregjeve të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve zanore është zona e operimit (mbulimit me rrjet) të operatorit përkatës ofrues të shërbimit territori i Republikës së Shqipërisë.

IV.2. Analiza për FNT e tregjeve te interkoneksionit

IV.2.1. Terminimi i thirrjeve ne rrjetet fikse

155. Për te analizuar ekzistencën apo jo te fuqisë se ndjeshme ne treg, AKEP-i përcakton nëse sipërmarrësit kanë fuqi të ndjeshme në treg, sipas procedurës së parashikuar në nenin 90 të këtij ligji, dhe bazuar në përcaktimet e nenit 88 të ligjit 54/2024, vlerëson një tërësi kriteresh të përcaktuara në këtë ligj, që duhet të merren në konsideratë.

²⁰Lista e operatoreve alternative eshte dhene ne Aneks 1.

156. Sipas përkufizimit të tregjeve përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse, çdo operator fiks është monopolist në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet dhe mund të konkludohet se secili prej tyre ka FNT. Megjithatë, terminimi i thirrjeve është një shërbim i cili i ofrohet operatorëve të tjerë të rrjeteve, dhe për të arritur në përfundimin se një operator ka FNT, që do të thotë aftësi ndikuese në përcaktimin e çmimit të këtij shërbimi pavarësisht operatorëve të tjerë apo konsumatorëve, është e rëndësishme të analizohen edhe disa faktorë të tjerë që ndikojnë në këtë aftësi ndikuese.
157. Në analizat e zhvilluara më parë nga AKEP, është arritur në konkluzionin se Albtelecom (tashmë One Albania pas bashkimit Albtelecom me One Telecommunications) dhe të gjithë operatorët alternative, janë operatorë me FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre:
- *Albtelecom sh.a. përmbush kushtet për t'u shpallur sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtarëve të rrjetit fiks Albtelecom;*
 - *Sipërmarrësi X përmbush kushtet për t'u shpallur sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtarëve të rrjetit fiks alternativ X;*
158. AKEP, si edhe në analizat e mëparshme për terminimin e thirrjeve (në rrjete fikse dhe celulare) edhe në këtë analizë ka trajtuar faktorët/kriteret e konsideruar me të rëndësishëm si pjesët e tregut, fuqia kundërvepruese e blerësve të shërbimit dhe tarifimi i shërbimit të terminimit.
159. Në vijim po paraqesim disa nga treguesit kryesorë që ndikojnë në përcaktimin e sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatës.

Pjesët e Tregut

160. Kontrolli 100% i rrjetit terminues nga secili ofrues i shërbimit të terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij, përbën në këtë mënyrë edhe 100% pjesë tregu, duke e identifikuar si monopolist në ofrimin e këtij shërbimi. Ky përcaktim mbi pjesën e tregut në masën 100% nga secili operator i telefonisë fikse ruan të njëjtën linjë arsyetimi të përdorur edhe në analizat pararendëse. Pjesa e tregut të terminimit të thirrjeve drejt abonentëve të rrjetit nuk varet nga madhësia e rrjetit, pasi pavarësisht madhësisë apo numrit të pajtimtarëve në rrjet, secili operator është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve drejt abonentëve të vet.
161. Pjesa e tregut prej 100% që secili operator ka në terminimin e thirrjeve në rrjetin e tij, nuk pritet të ndryshojë pasi nuk ka as alternativë teknike për zëvendësimin e tij:
- *Teknikisht nuk ka asnjë mundësi për terminimin e thirrjeve nga një rrjet A në një rrjet B pa ndërveprimin e operatorit që zotëron pajtimtarët drejt të cilëve është destinuar thirrja;*
 - *Barrierat e natyrës teknike janë të paevitueshme për të mundësuar shërbimin e terminimit të një rrjeti tjetër në mungesë të koordinimit dhe gjetjes së një vije sjellje të përbashkët në negociatat që mund të zhvillohen.*
162. Përcaktimin si monopolist në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve për çdo operator të telefonisë fikse e gjejmë edhe nga përkufizimi i tregjeve përkatës të identifikuar më

sipër, sipas të cilit çdo operator fiks është monopolist në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, dhe mund të konkludohet se secili prej tyre ka FNT. Megjithatë, terminimi i thirrjeve është një shërbim i cili i ofrohet operatorëve të tjerë të rrjeteve, dhe për të arritur në përfundimin se një operator ka FNT, që do të thotë aftësi ndikuese në përcaktimin e çmimit të këtij shërbimi pavarësisht operatorëve të tjerë apo konsumatorëve, kjo e përcakton si të rëndësishme të analizohen edhe disa faktorë të tjerë.

Fuqia Kundërvepruese dhe konkurrenca e mundshme në tregun e terminimit

163. Në analizat pararendëse, është arritur në konkluzionin që edhe operatorët alternativë aktivë në treg, ashtu si Albtelecom fiks (tashmë One Albania), plotësojnë kritere për FNT në këtë treg. Nëpërmjet rregullimit për sipërmarrësit e përcaktuar me status me FNT, AKEP përcaktoi tarifat e operatorëve në treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre. Nga praktika shumë vjeçare e marrëdhënieve midis operatorëve për negociatat për përcaktimin e tarifave të terminimit me marrëveshje komerciale rezultoi jo efikase, ndaj dhe instrumenti rregullues i kontrollit të tarifës së terminimit në nivelet maksimale të përcaktuara nga AKEP nëpërmjet procesit të analizës së tregut dhe masave rregullatore të vendosura, ka shërbyer si bazë e lidhjes dhe funksionimit të marrëveshjeve të tyre të interkoneksionit dhe nuk është vënë re që të jenë përcaktuar tarifa më të ulëta se nivelet maksimale për shkak të fuqisë kundërvepruese të operatorëve.
164. Për sa i përket konkurrencës së mundshme, për terminimin e thirrjeve në rrjetet fikse (dhe celulare) është arritur tashmë në konkluzionin se për shkak të karakteristikave teknike të ofrimit vetëm nga operatori i rrjetit përkatës të terminimit, ofrimi i këtij shërbimi nga secili operator nuk ndeshet me konkurrence të mundshme në treg për ofrim nga operatorë të tjerë të ndryshëm nga operatori i pajtimtarit ku përfundon thirrja telefonike.

Ecuria e tarifave të terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri

165. Në dokumentin e Analizës së tregut të telefonisë fikse, miratuar në Mars 2018, dhe me vendimet përkatëse të FNT, AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit dhe tranzitimit për Albtelecom dhe tarifat e terminimit për operatorët alternativë fiks, përfshirë One Telecommunications (tashmë One Albania pas bashkimit me operatorin Albtelecom) për One Telecommunications fiks, të përcaktuar me FNT.

Tabelat e mëposhtme paraqesin ecurinë e tarifave të interkoneksionit në rrjetet fikse në Shqipëri nga viti 2014 e në vijim, si edhe përfshijnë dhe tarifat e përcaktuara në vendimet e mëparshme të AKEP dhe afatet kohore të aplikimit të tarifave sipas Analizës së tregut 2018.

Tabela 16: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fiks One Albania (2014-2024)

	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018	1.01.2019-	1.12.2024
Terminim – (lek/minute)							
Lokal	1.34	1.19	1.48	1.29	1.00	0.70	0.70

Njfish							
Dyfish	2.68	1.85					
Tranzitim (lek/minute)							
Njfish	1.71	1.32	0.93	0.81	0.63	0.44	0.44
Dyfish							
Tarife për thirrje (lek/thirrje)	0.53	0.38	0	0	0	0	0
POI	12	12	12	12	2	2	2

Shënim: Tarifat në Lek/Minutë pa TVSH

Tabela 17: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të OA dhe One Telecommunications (tashmë One Albania) për One Telecommunications fiks (2014-2024)

	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018	1.01.2019	1.12.2024
OA							
Lokal	1.5	1.34	1.48	1.29	1.00	0.70	0.70
Mesatare-Njfish/dyfish	2.42	1.77					
Tarife fikse për thirrje	0.53	0.38	0	0	0	0	0
One Telecommunications							
Terminimi lek/minute	1.34	1.19	1.48	1.29	1.00	0.70	0.7
Tarife fikse për thirrje	0.53	0.38	0	0	0	0	0

Shënim: Tarifat në Lek/Minutë pa TVSH

166. Tarifat e terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri janë reduktuar në bazë të vendimeve të AKEP dhe jo për shkak presionit konkurrues me të cilin ndeshen operatorët apo faktorë të tjerë si fuqia kundërvepruese. Tarifat e terminimit janë përcaktuar në nivelet maksimale të lejuara nga AKEP dhe nuk ka pasur tendenca për përcaktim të tarifave poshtë këtyre niveleve. Tarifat aktuale të terminimit në rrjetet fikse janë reduktuar ndjeshëm në vitet e fundit, por ende janë më të larta se tarifat mesatare në vendet e BE. Në mungesë të rregullimit *ex-ante* me statusin me FNT operatorët do të mund të aplikojnë tarifa mbi nivelet e rregulluara dhe vlera të ndryshme për operatorë të ndryshëm (diskriminim).

IV.2.2. Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse (FTR)


167.

ë Shqipëri, duke filluar nga data 1.01.2016, AKEP ka përdorur metodën e rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark) duke aplikuar një reduktim të përshkallëzuar (*glide path*), për unifikimin e tarifës së terminimit (simetrike për të gjithë operatorët fiks). Tarifa e terminimit në rrjetet fikse të ofrimit të shërbimit të terminimit aktualisht është në vlerën maksimale 0.70 lekë/min, e cila është sa tarifa mesatare

N

(benchmark) e vendeve të BEREC që aplikojnë një segment dhe sa mesatarja e tre segmenteve në vendet e BEREC dhe BE, më 1.01.2014.

Figura 12: Ecuria e tarifave FTR për Shqipërinë 2016-2024



Burimi: AKEP

168. Në përdorimin e metodologjisë së rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark) AKEP ka marrë parasysh Rekomandimin e KE-së Maj 2009 për trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet mobile dhe rrjetet fikse, si dhe kushtet e tregut të telefonisë fikse në Shqipëri. Rekomandimi i KE-së përcakton vendosjen e tarifave simetrike për FTR sipas kostos së operatorit efikas. Përcaktimi i tarifave të terminimit të orientuara në kosto është në përputhje me kuadrin rregullator (ligji i komunikimeve elektronike Nr.9918, i ndryshuar). Përdorimi i metodologjisë benchmark për përcaktimin e tarifave të terminimit ka gjeneruar rezultate efikase në përcaktimin e tarifave të terminimit. Në rekomandimin e KE (2009/396/EC) i rekomandohet autoriteteve rregullatore mundësia e aplikimit të një metode alternative (siç është metoda benchmark) për vendet që nuk kanë mundësi të implementojnë modelin e kostove LRIC për arsye të burimeve të kufizuara. AKEP do të vijojë me përdorimin e metodës së rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark) për përcaktimin e tarifave të terminimit në rrjetet fikse (FTR).

Përfundime mbi FNT në tregjet e terminimit:

169. Bazuar në përfundimet e arritura me sipër, AKEP vlerëson se statusi me FNT përcaktohet për të gjithë ofruesit e shërbimit të telefonisë fikse të cilët ofrojnë shërbimin e terminimit në rrjetet e tyre, rrjedhimisht janë operatorë me FNT në terminimin e thirrjeve publike të ofruara nga rrjetet fikse në rrjetet e tyre:

- ***One Albania sh.a. përmbush kushtet për t'u shpallur sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtarëve të rrjetit fiks One Albania;***
- ***Sipërmarrësi X (Vodafone Albania fiks + të gjithë OA operatorët alternative) përmbush kushtet për t'u shpallur sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve drejt pajtimtarëve të rrjetit fiks alternativ X;***

170. Lista me operatorët alternativë (të referuar më sipër si Sipërmarrësi X) të propozuar për status me FNT për terminimin në rrjetet e tyre është dhënë në Aneks 1 të këtij dokumenti të analizës. Lista është hartuar duke u bazuar në të dhënat e Regjistrisë të Autorizimit të

përgjithshëm, si dhe të dhënat e regjistrit të Autorizimit Individual për sipërmarrësit e pajisur me numeracion gjeografik Fiks deri më 10.06.2025. Pra sipërmarrësit që përcaktohen me FNT janë sipërmarrësit që kanë njoftuar për ofrim rrjeti publik telefonik fiks (rrjet publik fiks dhe telefoni fikse) sipas të dhënave të Regjistrit të AP dhe që njëkohësisht janë pajisur me numeracion gjeografik fiks deri në efektet e vendimeve që burojnë nga ky dokument.

IV.2.3. Tranzitimi i thirrjeve ne rrjetet fikse

171. Tranzitimi i thirrjeve shërben për të lidhur dy rrjete që nuk kanë lidhje direkte me njëri-tjetrin apo kur kjo lidhje direkte nuk konsiderohet ekonomike nga palët. Për tranzitimin e thirrjeve kombëtare One Albania (ish Albtelecom) aktualisht është operator me FNT, mbi të cilin ka masa rregullatore përfshirë dhe kontrollin për tarifat e tranzitimit, të cilat rregullohen nga AKEP. Shërbimi i tranzitimit kërkohej nga operatorët e rrjeteve fiks për të kompletuar thirrjet telefonike të përdoruesve të tyre drejt rrjeteve të tjera (jo të interkonektuar direkt). Në analizat pararendëse, përfshirë edhe analizën e vitit 2018, AKEP ka dhënë përkufizimin e këtij shërbimi, i cili është i publikuar edhe në RIO-n e One Albania, në të cilën është përcaktuar edhe tarifa maksimale për tranzitim të One Albania, e cila aktualisht është 0.44 lek/minutë, pas reduktimit të saj nëpërmjet masës rregullatore të kontrollit të tarifës së tranzitimit nga nivelet e mëparshme të kësaj tarife. Duke konsideruar se:
- Volumi i trafikut të tranzituar ka rënie të konsiderueshme dhe periodike sipas evidencave statistikore të raportuara në AKEP, për arsye të cilat janë cituar dhe në seksionin më sipër;
 - Pjesët e tregut të tranzitit të thirrjeve kombëtare kanë ndryshuar në favor të operatorëve të tjerë tranzitues në këtë treg, duke përmbytur peshën e operatorit One Albania (ish Albtelecom) i cili mban aktualisht dhe statusin me FNT;
 - Ky treg është konsideruar si treg i nevojshëm për tu analizuar dhe vlerësuar për FNT, pasi është aplikuar testi i 3 kritereve në analizat pararendëse, si një imponim nga Rregullorja e Analizës së Tregut të AKEP, që nga momenti që është hequr nga lista e tregjeve të nevojshme për ndërhyrje ex-ante nga BE dhe mbi këtë bazë është analizuar dhe vlerësuar.
172. Ndaj, në këto kushte edhe në dokument paraprakisht do aplikohet testi i 3 kritereve duke konsideruar evoluimin e këtij tregu për periudhën 2018-2024, të faktorëve të brendshëm të lidhur me kërkesë – ofertën për produktin e shërbimit të tranzitimit kombëtar dhe mbi këtë bazë të konkludohet mbi nevojën ose jo për ndërhyrje ex-ante në këtë treg.
173. Siç edhe është bërë e qartë edhe në analizat pararendëse, testi i tre kritereve është një metodologji që aplikohet për të përcaktuar nëse një treg specifik duhet të jetë i rregulluar nga autoritetet kombëtare të rregullimit, pra rregullim ex-ante, duke e vlerësuar këtë treg edhe pse tregu i tranzitit të thirrjeve telefonike në rrjetet fikse nuk është më pjesë e listës së tregjeve të rekomanduara për rregullim nga BE, autoritetet kombëtare mund të zgjedhin ta rregullojnë atë nëse plotësohen tre kriteret.

Tre kriteret e testit të aplikuar dhe nevojshme për ri-vlerësim në mënyrë sintetike janë:

1. ***Barriera të larta hyrjeje në treg:*** Tregu duhet të karakterizohet nga barriera të larta hyrjeje që pengojnë konkurrencën efektive.

2. **Prirja për konkurrencë e pamjaftueshme:** Struktura e tregut duhet të tregojë se nëse hiqet rregullimi, konkurrenca nuk do të zhvillohet në mënyrë të kënaqshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.
3. **Rregullimi ex-post nuk është i mjaftueshëm:** Vetëm mjetet juridike të zbatimit të ligjit të konkurrencës (rregullimi ex-post) nuk janë të mjaftueshme për të adresuar problemet e konkurrencës në treg.

174. Në rastin konkret, për tregu i tranzitit të thirrjeve telefonike në rrjetet fikse nga vlerësimi i evidencës statistikore për periudhën 2018 - 2024, konstatohet se:

- Treguesi i lidhur me **kriterin e parë**, mbi prezencën e barrierave (me natyrë strukturore, juridike dhe ekonomike), pavarësisht se nuk jemi në kushtet që të konsiderohen barrierat ligjore pasi ofruesit e shërbimit të tranzitimit e kanë të lehtë hyrjen në këtë treg për kundrejt një njoftimi dhe përzgjedhjen e këtij shërbimi për ta ofruar, gjë e cila faktotet edhe numri i tyre (18 ofrues) të këtij shërbimi të evidentuara nga regjistri përkatës. Por gjithësisht në kushte kur nevoja për tregun e tranzitit kombëtar nënkupton mbulim gjeografik kombëtar dhe jo densitete ofruesish por kryesisht të pozicionuar lokalisht në zona me densitet popullsie, atëherë barrierat me natyrë strukturore dhe ekonomike mbetet një barrierë për t'u konsideruar, me argumentin kryesor të prezencës infrastrukturës.
- Treguesi që lidhet **kriterin e dytë**, me nivelin e mjaftueshëm të konkurrueshmërisë, pra prezencë të operatorëve të rinj, apo ekzistues, në përmirësim të kapaciteteve tranzituese për mundësimin e shërbimit të tranzitimit të thirrjeve të telefonisë fikse, kryesisht në zonat urbane me densitet dhe volum të këtij trafiku, rezultojnë të këtij konkurrueshmëri të mjaftueshme për tu konsideruar. Sipas evidencës të AKEP, tregu i tranzitit të thirrjeve telefonisë fikse aktualisht ka rreth 18 ofrues të këtij shërbimi të autorizuar, por 3 ose 4 prej tyre kanë rezultuar të jenë aktive në ofrimin e këtij shërbimi në segmentin kohor 2018-2024. Ka rëndësi të evidentohet fakti se volumi i trafikut të tranzituar ka rënë të konsiderueshme dhe periodike sipas evidencave statistikore të raportuara në AKEP dhe në të njëjtën kohë tarifa e tranzitimit në ofrimin e këtij shërbimi ka pësuar rënie të vazhdueshme duke qenë se ky treg ka qenë në rregullim ex-ante periodikisht për specifika të ndryshme kombëtare të evidentuara në analizat pararendëse. Vlera e kësaj tarife dhe volumi i këtij trafiku nuk impaktojnë në mënyrë domethënëse financat e rrjeteve ofruese ose përfituese të këtij shërbimi, rrjedhimisht impakti i mos rregullimit të këtij tregu është gjithnjë e më i vogël. Përveç sa sipër, bazuar në të dhënat e analizuara volumi i trafikut kombëtar të tranzituar është jo vetëm në rënie periodike, por bëhet fjalë për një volum thirrjesh i cili i vlerësuar financiarisht është i papërfillshëm për shëndetin financiar të ofruesit të shërbimit.
- Treguesi i cili lidhet me **kriterin e tretë** të testit, mbi mundësinë e rregullimit ex-post dhe mjaftueshmërinë e tij për të adresuar problemet e konkurrencës në këtë treg, në kushtet dhe rrethanat e reja dhe ndryshimit të pjesëve të tregut në këtë treg nuk është se ka pasur ndonjë rast specifik të evidentuar, por ajo që konsideron vëmendje dhe mbi të cilën mund të arsyetohet, vlerësohet se për çdo rast të nevojshëm për ndërhyrje në tregun e tranzitimit të trafikut telefonik fikse, duhet konsideruar si opsion efektiv edhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve të mundshme, duke përfshirë dhe elemente mosmarrëveshjeje të lidhura me tarifimin e këtij shërbimi. Në këtë rast, specifikat e këtij tregu e adresojnë për zgjidhje me efikasë ndërhyrjen ex-ante në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të këtij lloji, por pa përjashtuar edhe rregullimet e mundshme ex-post, pra mund të adresohet çdo problem i mundshëm me mjete ex-post, por edhe zgjidhje të mosmarrëveshjeve nga autoriteti rregullator i fushës për çdo element mosmarrëveshjeje, atëherë nuk ka nevojë për rregullim ex-ante.

175. Konteksti i tregut te tranzitit ne telefoninë fikse ne Shqipëri, ku aktualisht ka një operator me fuqi te ndjeshme One Albania (ish- Albtelecom), i cili ka pasur një pozitë të ndjeshme në tregun e tranzitit të thirrjeve në telefoninë fikse ne një historik te gjate kohor, evidencat statistikore dhe evoluimi i tregut ne raport me kërkesë/ofertën ne këtë treg, identifikojnë qartësisht se kushtet në këtë treg janë ndryshuar ndjeshëm.
176. Mbi sa sipër, vlerësohet se testi i **tre kriterëve** mund të jetë një mjet i rëndësishëm për të përcaktuar nëse ky treg duhet të hiqet nga rregullimi. Pra e thënë në mënyrë të përmblodhur, mbi vlerësimin ose jo për përcaktimin e statusit të fuqisë së ndjeshme në treg, AKEP verifikon dhe konsideron ne përputhje me kriteret e ligjit kushtet e tregut nëse One Albania (ish- Albtelecom) ka ende fuqi të ndjeshme në tregun e tranzitit te thirrjeve kombëtare ne telefoninë fikse.
177. Por, pavarësisht konkluzioneve te mësipërme, vlerësimi i testit te tre kriterëve konsiderohet i nevojshëm sa kohe ky treg është vendosur ne rregullim *ex-ante* bazuar mbi testin përkatës ne rrethanat specifike kombëtare, pasi ky test përcakton nëse tregu kërkon ndërhyrje të mëtejshme rregullatore. Ne analizat pararendëse te tregut te tranzitit kombëtar ne telefoninë fikse është identifikuar Albtelecom si operator me fuqi te ndjeshme dhe me pjese tregu mbi 70% dhe nga aplikimi i testit te 3 kriterëve ka rezultuar se testi plotësohej, edhe pse tregu është i liberalizuar plotësisht dhe natyra e tregjeve te tranzitit është konkurruese. Kjo ka qene dhe arsyeja kryesore pse ky treg është hequr nga lista e tregjeve te nevojshme për ndërhyrje ex-ante nga BE. Ne segmentin kohor te analizuar, nga evidencat e te dhënave statistikore rezulton se kriteri i konsideruar si barriere me natyre ekonomike ne analizën pararendëse e ka humbur rëndësinë e tij, pasi operatori tranzitues Info Telekom duke filluar nga vitit 2022 dhe ne vijim, për një periudhe 3 vjeçare ka përmbysur peshën e Albtelecom ne këtë treg, duke zvogëluar pjesën e tregut te Albtelecom ne tregun e tranzitit kombëtar te thirrjeve ne rreth 30%. Ne këto kushte ndryshon dhe vlerësimi për kriteret e testit te konsideruara te nevojshme dhe te cilat kane shërbyer si zanafille e mbajtjes se analizës se këtij tregu si dhe e identifikimit te Albtelecom me status me fuqi te ndjeshme ne këtë treg, duke konsideruar specifikat e rrethanave kombëtare. Në këtë rast, ku tregu i tranzitit kombëtar të thirrjeve në telefoninë fikse në Shqipëri ka pësuar ndryshime strukturore të rëndësishme dhe pjesa e tregut e Albtelecom ka rënë ndjeshëm (nga mbi 70% në rreth 30%), rrethanat specifike kombëtare për të vlerësuar rregullimin e këtij tregu dhe në testimin e tre kriterëve sipas ndryshimeve të fundit, tregu i tranzimit të thirrjeve nga rrjetet fikse nuk i plotëson testin e tre kriterëve dhe si i tillë nuk vijohet me analizimin e këtij tregu për evidentimin e sipërmarrësve me FNT.


178. Pjesët e tregut si evidence referuese

Sipas të dhënave të depozituara nga operatorët pjesët e tregut të Albtelecom për shërbimin e tranzitimit të thirrjeve kombëtare janë dhënë në tabelën e mëposhtme për 2018- 2024.

Tabela 18: Pjesët e tregut të One Albania dhe Info Telecom për tranzitim thirrjesh kombëtare të telefonisë fikse

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
<i>One Albania (ish- Albtelecom)</i>	82%	78%	77%	71%	48%	30%	33%
<i>Info Telecom</i>	18%	22%	22%	29%	52%	69%	66%

Figura 13: Ilustrim i ecurisë së trafikut kombëtar fiks të tranzituar 2018-2024



Burimi: Të dhëna nga operatorët. Përpunimi AKEP

179. Nga sa më lart konstatohet se gjatë tre viteve të fundit vihet re një rënie e pjesës së tregut të Albtelecom, duke arritur në 30% për volum thirrjesh dhe rreth 58% për të ardhura në vitin 2023 krahasuar me 48% për volum të thirrjeve dhe 57% për të ardhura nga tranzitimi i këtyre thirrjeve në vitin 2022. Siç vihet re, në dy vitet e fundit, veçanërisht në vitin 2023, ka një rënie të ndjeshme në volumin e thirrjeve, ku edhe në vitin 2024 pjesa e One Albania rezulton rreth 33%, por në volum minutash të tranzituara në të njëjtin nivel sa viti 2023 (rreth 2.2 milionë minuta).

180. Ndryshimet e mëdha në pjesët e tregut për tranzitimin e thirrjeve kombëtare tregojnë se operatorët alternative kanë tejkaluar barrierat për ofrimin e shërbimit të tranzitit kombëtar. Kjo reflektohet nga ndryshimi i pjesëve të tregut por edhe nga numri i operatoreve tranzitues në këtë treg. Volumi kryesor i trafikut të thirrjeve fikse kombëtare për tu tranzituar, i cili është kryesisht i lokalizuar në zonat urbane me densitet, aty ku dhe ka prezence të më shumë se dy operatoreve tranzitues por edhe kapacitete tranzitimi të mundshme për tu aktivizuar për këtë shërbim.

Nga rezultatet e evidencës statistikore dhe interpretimit të treguesve të vlerësuar rezulton se:

- Konkurrenca është rritur ndjeshëm (18 ofrues të autorizuar, ku 5 prej tyre aktive në segmentin kohor të analizuar), pra ka infrastrukturë alternative për transitin kombëtar dhe kapacitetet të mjaftueshme për të mundur tranzitimin kombëtar të thirrjeve telefonike fikse nga operatorët e autorizuar në ofrimin e këtij shërbimi ;
- Pjesa e tregut të One Albania (ish-Albtelecom) është zvogëluar dukshëm, duke kaluar operator i dytë në peshën që mbart në tranzitimin e trafikut kombëtar fikse, gjë e cila tregon se konkurrueshmëria në këtë treg ka lejuar për të mundur ndryshimin e treguesve për ofruesit e rinj;
- Nuk barrierat hyrjeje me natyrë strukturore, juridike dhe ekonomike për operatorë të rinj apo ekzistues, barrierat të cilat do të kërkonin nevojën e mbajtjes në rregullim ex-ante të këtij tregu;

Konkluzioni për tregun e tranzitit kombëtar

Bazuar në sa sipër, si dhe faktin që ky treg nuk është në listën e tregjeve përkatës të rekomandimit të KE për tregjet përkatës, rrjedhimisht nuk është as në listën e tregjeve të Rregullores së Analizës së Tregut, AKEP ka kryer testin e 3 kritereve nëse ky treg është i justifikuar për ndërhyrje *ex-ante* apo jo. Nga analiza e tre kritereve rezulton se dy prej tyre nuk plotësohet dhe në përputhje me rregulloren e analizës së tregut dhe rekomandimet e KE, tregu

me shumicë i shërbimit tranzit të thirrjeve telefonike kombëtare në rrjetet telefonike publike të ofruara nga vendndodhje fikse, nuk plotëson testin e tre kriterëve dhe nuk konsiderohet si treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante, rrjedhimisht konstatohet se:

Në tregun përkatës të tranzitimit të thirrjeve kombëtare nuk ka dominancë nga asnjë prej ofruesve të shërbimit të tranzitit kombëtar për thirrjet e telefonisë fikse.

Heqja e detyrimeve në tregjet e de-rregulluara

Atëherë nga sa arsyetuar më sipër, si dhe në mbështetje të të dhënave statistikore të cituara më sipër, One Albania (ish- Albtelecom) vlerësohet të ketë humbur statusin e fuqisë së ndjeshme. Në bazë të përcaktimeve të ligjit 54/2024, rregullores së analizës së tregut dhe direktivave dhe rekomandimeve të BE/BEREC, propozohet që detyrimet ndaj sipërmarrësit One Albania (ish- Albtelecom) për FNT në këtë treg të përcaktuara në analizën pararendëse propozohet të hiqen. Heqja e këtyre detyrimeve propozohet të bëhet pas marrjes së vendimit për FNT dhe masat rregulluese për One Albania (ish- Albtelecom) sipas konkluzioneve të versionit final të kësaj analize tregu, pas këshillimit publik.

V. Masat rregulluese për operatorët me FNT

Në bazë të analizës së kryer për tregjet e telefonisë fikse, rezulton se:

Sipërmarrësi One Albania sh.a vlerësohet se përmbush kushtet për t'u shpallur me FNT në tregjet përkatës të mëposhtëm:

- **Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik One Albania të ofruar nga vendndodhje fikse;**

Sipërmarrësi X²¹ i rrjetit alternativ X vlerësohet se përmbush kushtet për t'u shpallur me FNT në tregun e shumicës të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin e tij, konkretisht në tregun:

- **Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të operatorit X të ofruar nga vendndodhje fikse.**

181. Në pikën 2, të nenit 92 të ligjit 54/2024, parashikohet se kur një sipërmarrës përcaktohet se ka fuqi të ndjeshme në një treg përkatës, mbi bazën e një analize tregu, të kryer në përputhje me këtë ligj, AKEP-i, sipas rastit, vendos detyrimet e përcaktuara në nenet 93 deri në 99 dhe në nenet 101 dhe 106 të këtij ligji. Në përputhje me objektivat e nenit 5 të këtij ligji, dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, AKEP-i zgjedh mënyrën më efikase dhe me sa më pak ndërhyrje për adresimin e problemeve të evidentuara në analizën e tregut.

182. Pika 3 e Nenit 92 të ligjit 54/2024, përcakton midis të tjerave se AKEP-i vendos detyrimet e përcaktuara në nenet 93 deri 99, 101 dhe 106 të këtij ligji, vetëm për sipërmarrësit që janë përcaktuar me fuqi të ndjeshme në treg, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, dhe pa cenuar:

- a. a) parashikimet për aksesin sipas kreut XII të këtij ligji;
- b. nenet 58 dhe 36 të këtij ligji, si dhe çdo angazhim që sipërmarrësi që merr të drejtat e përdorimit, ka bërë në kuadrin e një procesi të rinovimit të autorizimit ose përpara dhënies së autorizimit, ose, sipas rastit, ndaj ftesës për aplikim për të drejtat e përdorimit, nenet 135 dhe 145 të këtij ligji dhe dispozitat përkatëse të kreut XIX të këtij ligji, që përmbajnë detyrime ndaj sipërmarrësve, të ndryshme nga ato të përcaktuara si me fuqi të ndjeshme në treg; ose
- c. nevojën për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare.

183. Pika 3, e nenit 90 të ligjit 54/2024, parashikon se kur AKEP-i arrin në përfundimin se një treg përkatës nuk e justifikon vendosjen e detyrimeve rregullatore, në përputhje me procedurën e pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ose kur kushtet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, nuk përmbushen, AKEP-i nuk vendos ose nuk mban ndonjë detyrim specifik rregullator në përputhje me nenin 92 të këtij ligji. AKEP-i heq detyrimet e vendosura ndaj sipërmarrësit në tregun përkatës, duke siguruar që palët e ndikuara nga ky vendim të njoftohen në një periudhë të përshtatshme kohore.

184. Për sa më sipër rezulton se tregu përkatës në të cilin janë evidentuar sipërmarrës me FNT është tregu i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të telefonisë fikse. AKEP në analizat e mëparshme ka evidentuar problematikën e FNT në këto tregje dhe

²¹ Sipas listës në Aneksin 1 bashkëlidhur

problematika e tregut të terminimit në rrjetet fikse është tashmë e mirë trajtuar pasi ato janë probleme standarde që do të ekzistojnë në kushtet e mos-rregullimit *ex-ante*:

- refuzimi për të dhënë akses në rrjet për shërbimet e interkoneksionit;
- vonesat për dhënien e aksesit;
- mosdhënie e informacionit;
- aplikimi i kushteve diskriminuese midis operatorëve të ndryshëm;
- aplikimi i kushteve të padrejta në marrëveshje interkoneksioni.

185. Seksionet e mëposhtme përmbajnë propozimet e AKEP për detyrimet e operatorëve me FNT, duke u fokusuar në rregullimin e tarifave të terminimit, si dhe heqjen e detyrimeve për tregjet e de-rregulluara.

V.1. Masat rregullatore për tregjet me shumicë të interkoneksionit

V.1.1. Masat rregullatore të propozuara për One Albania

186. AKEP gjykon se karakteristikat e tregjeve me shumicë nga FNT e One Albania për terminimin e thirrjeve kombëtare ruajnë të njëjtën natyrë me ato të identifikuar në analizën e mëparshme, kështu që ndaj operatorit me FNT One Albania propozohet që vendosen detyrimet si më poshtë vijon:

1. *Detyrimi i transparencës (Neni 93);*
2. *Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 95);*
3. *Detyrimi për akses dhe përdorim të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve shoqërues (Neni 98);*
4. *Tarifa e Terminimit (Neni 100).*

187. Përveç detyrimeve të cituara më sipër, për One Albania propozohet të zbatohet dhe detyrimet e Ligjit 54/2024 për Marrëveshjet e Aksesit të parashikuara në nenin 94 të këtij ligji, përfshirë afatet kohore të dhënies së ofertës së aksesit kërkuar dhe dorëzimin në afat të MI-ve dhe publikimin/përditësimin e RIO. Detajimi i detyrimeve të operatorëve me FNT në lidhje me interkoneksionin, si edhe RIO janë pjesë e rregullores të Aksesit dhe Interkoneksionit.

188. One Albania duhet të vazhdojë të publikojë gjithashtu marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement-SLA), si dhe Tregues Kryesorë të Performancës (Key Performance Indicators - KPI) për interkoneksionin sipas përcaktimeve të Rregullores të Aksesit dhe Interkoneksionit.

189. Në kushtet e de-rregullimit të tregut me shumicë të shërbimit tranzit të thirrjeve telefonike kombëtare në rrjetet telefonike publike të ofruara nga vendndodhje fikse, atëherë detyrimet aktuale të vendosura ndaj operatorit One Albania (ish-Albtelecom) nga analizat pararendëse, propozohet të hiqen. Afati për tërheqjen e masave rregullatore në fuqi, përcaktohet në vendimin e KD-se, sipas përcaktimeve të ligjit 54/2024, heqja e detyrimeve bëhet efektive pas marrjes së vendimeve të AKEP (në versionin final të analizës dhe vendimmarrjes përkatëse pas përfundimit të kështillimit publik të këtij dokumenti, si dhe të qëndrimeve përkatëse që do të vlerësohen mbi propozimet e paraqitura në këtë dokument).

V.1.2. Masat rregullatore të propozuara për terminimin në rrjetet e Operatorëve Alternativë

190. AKEP ka vlerësuar nëpërmjet analizës, që operatorët alternativë të rrjeteve të telefonisë fikse plotësojnë kushtet për FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale. Në lidhje me masat rregullatore/detyrimet për FNT të këtyre operatorëve AKEP gjykon që të kenë të njëjtat detyrime të vendosura edhe në analizën e tregut të kryer në vitin 2018:

1. Detyrimi i transparencës (Neni 93);
 2. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 95);
 3. Detyrimi për akses dhe përdorim të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve shoqërues (Neni 98);
 4. Tarifa e Terminimit (Neni 100).
- Detyrimi i mosdiskriminimit përfshin ndalimin e aplikimit të tarifave të ndryshme të terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare për operatorë të ndryshëm kombëtar origjinues të thirrjeve të terminuara në rrjetin e operatorit alternativ. Pra nëpërmjet këtij detyrimi një operator alternativ nuk mund të aplikoje tarifa të ndryshme terminimi për operatorë të ndryshëm si celulare ashtu edhe fikse. AKEP, si edhe në analizat e mëparshme gjykon që operatorët alternativë të mos kenë detyrim për publikimin e ofertës referencë të interkoneksionit, pasi kjo masë nuk është e nevojshme dhe do të ishte jo-proporcionale.
 - Detyrimi i transparencës përfshin publikimin nga operatori alternativ të tarifës/tarifave të terminimit në rrjetin e tij si dhe të adresës së pikës së interkoneksionit me këtë rrjet. Në kushtet e mos-vendosjes së detyrimit për publikim RIO ky detyrim gjykohet i nevojshëm për zbatimin e mos-diskriminimit në tarifa. Detyrimi i dhënies akses për interkoneksion është detyrim që operatorët e rrjeteve publike telefonike të japin akses për terminimin në rrjetet e tyre me qëllim realizimin e interkoneksionit të rrjeteve publike telefonike.

V.2.. Rregullimi i tarifave me shumicë të interkoneksionit

V.2.1. Rregullimi i tarifave të FTR deri në vendimmarrjen e vitit 2018

191. Tabela e mëposhtme paraqet nivelet tarifave të interkoneksionit të rrjeteve fikse të përcaktuara sipas analizave të mëparshme përfshirë edhe atë të vitit 2018 për One Albania dhe operatorët e tjerë.

Tabela 19: Ecuria e tarifave të interkoneksionit 2014-2024

	1.09.2014	1.01.2016	1.01.2017	1.12.2018	01.12.2019	1.12.2020	1.12.2024	Ndryshimi 2024/2018
One Albania (ish Albtelecom) terminim:								
Lokal/Njëfish	1.19	1.48	1.29	1.00	0.7	0.7	0.7	30%

Dyfish	1.85							
POI	12	12	12	2	2	2	2	0%
One Albania (ish Albtelecom) transit kombetar:	1.32	0.93	0.81	0.63	0.44	0.44	0.44	30%
OA terminim:								
Lokal	1.34	1.48	1.29	1.00	0.7	0.7	0.7	30%
Mesatare-Njëfish/dyfish	1.77							
One Telecommunications	1.19	1.48	1.29	1.00	0.7	0.7		30%

Shënim: Tarifat në Lek pa TVSH

192. Siç mund të vihet re nga tabela e mësipërme tarifa FTR e cila ka hyrë në fuqi në 1.12.2019 ka pasur një reduktim me 30% të FTR të të gjithë operatorëve të rrjeteve fikse, si dhe të tranzitimit të One Albania. Kjo përbën një reduktim të konsiderueshëm edhe të të ardhurave nga terminimi për të gjithë operatorët e rrjeteve fikse dhe në kushtet specifike të Shqipërisë për rrjetet fikse.

V.2.2. Skema e re reduktimit të FTR në Shqipëri

193. AKEP propozon që tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet e operatorëve që ofrojnë shërbimin e telefonisë fikse të rishikohen sipas vlerave dhe afateve të mëposhtme, ku për përcaktimin e tarifave të terminimit është përdorur tarifa e përcaktuar në rregulloren e BE 2021/654 (Commission Delegated Regulation (EU) 2021/654), si edhe krahasimi me tarifat mesatare të vendeve të rajonit.

Tabela 20: Propozimi për reduktimin e tarifave të interkoneksionit në rrjetet fikse

	Aktualisht	01.12.2025	01.06.2026	01.12.2026	Ndryshimi 2025/2024
One Albania (Lokal/Njëfish)	0.7	0.3	0.15	0.07	-57%
Operatorët Alternativë (Lokal/Njëfish)	0.7	0.3	0.15	0.07	-57%

Shënim: Tarifat në Lek pa TVSH

194. Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) dhe reduktimi i përshkallëzuar është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga Ligji 54/2024, neni 6, pika 3 dhe neni 100, pika 8.

Aneks 1. Lista e sipërmarrësve të rrjeteve publike telefonike fikse të propozuar për status me FNT në terminimin e thirrjeve

Tabela e mëposhtme paraqet listën e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete publike fikse dhe të pajisur me numeracion gjeografik fiks për pajtimtarë, përditësuar deri më datë 10.06.2025.

Kjo listë mund të përditësohet nga AKEP në përfundim të procesit të kësaj analize tregu me emrat e operatorëve aktivë të rrjeteve të telefonisë fikse që do të përcaktohen me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale të telefonisë fikse. Lista e sipërmarrësve OA²² që ofrojnë shërbime të telefonisë fikse

Nr.	Sipërmarrësi Alternativ
1	Vodafone Albania sh.a (f)
2	Abissnet sh.a.
3	Albon sh.p.k
4	Asc sh.a.
5	Digicom sh.p.k
6	Ej & Bi sh.p.k
7	Mobix telecom sh.p.k
8	Enet sh.p.k
9	FBD sh.p.k
10	Info Telecom sh.p.k
11	Mc Networking sh.p.k
12	Metis Communications sh.p.k
13	Mobitel Communications sh.p.k
14	Neofone sh.a
15	Nisatel sh.p.k
16	One Albania sh.a (f)
17	Pegasus Communications sh.p.k
18	Professional Technologies sh.p.k
19	Sabatel sh.p.k
20	Safecomm sh.p.k.
21	Selcom sh.p.k
22	Sintel sh.p.k
23	Tele.Co&Constructions sh.p.k
24	VoipAlbano sh.p.k
25	Telekom-Ko sh.p.k
26	Tibo Communications sh.p.k
27	Ultrahet sh.p.k
28	Voskopë sh.p.k
29	“Albanian Fiber Telecommunications” sh.p.k

²² Detyrimet janë të njëjta edhe për sipërmarrës të tjerë aktivë që do të ofrojnë shërbime të telefonisë fikse të terminimit të thirrjeve kombëtare.

Aneks 2. Lista e Pyetjeve për këshillim publik

Më poshtë është një përmbledhje e pyetjeve për të cilat AKEP është i interesuar të marrë komente nga palët e interesuara. Në përgjigjet e dhëna për pyetjet, palët janë të lutura të përfshijnë edhe argumentim për përgjigjet/komentet. Palët mund të japin komente edhe për pjesë të tjera të dokumentit të nxjerrë në këshillim dhe propozimeve të AKEP, apo dhe sugjerime shtesë për një rregullim sa më të mirë të tarifave me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet e telefonisë fikse.

- 1. Cili është opinionimi juaj për stadin aktual të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare të telefonisë fikse dhe reduktimin e përshkallëzuar sipas metodologjisë së benchmarkut të vendeve të BE-së dhe rajonit?*
- 2. Çfarë mendoni në lidhje me ecurinë e tregut të telefonisë fikse në Shqipëri, a pritet të ketë ndryshime në pjesët e këtij tregu?*
- 3. A jeni dakord me përfundimet e AKEP për përkufizimin e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet individual fikse?*
- 4. A mendoni se të gjithë operatorët aktivë të rrjeteve telefonike publike fikse, përmbushin kriteret për FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale?*
- 5. A mendoni se në kushtet aktuale dhe në përputhje me gjetjet nga evidenca statistikore të referuara në dokument, tregu i tranzitimit të thirrjeve kombëtare të telefonisë fikse nuk është e nevojshme të ketë ndërhyrje ex-ante, pra ky treg duhet të jetë i de-rregulluar?*
- 6. A mendoni se çdo mosmarrëveshje e mundshme në tregun e tranzitit të thirrjeve kombëtare të telefonisë fikse është e mundur të adresohet për zgjidhje nga rregullatori i fushës AKEP dhe se instrumentet ligjore sigurojnë zgjidhje efikase në raste hipotetike të mosmarrëveshjeve të mundshme?*
- 7. Çfarë mendoni për masat rregullatore të propozuara në këtë dokument për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet fikse?*
- 8. Cili është opinionimi juaj në lidhje me skemën e re të reduktimit të FTR të të gjitha rrjeteve fikse?*